



WFD

WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

SIGURIA PUBLIKE VS. MBROJTJA SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SITUATA EMERGJENTE



Funded by
UK Government

SIGURIA PUBLIKE VS. MBROJTJA SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SITUATA EMERGJENTE

Ekipi hulumtues: Dr. Elton Skendaj, Dr. Roland Lame, Dr. Meg Gardinier

Autorët prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Fondacionit Westminster për Demokraci.

Tiranë, Shkurt 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e Figurave	4
Lista e Termave dhe Përkufizimeve	5
1. Përmbledhje Ekzekutive	6
2. Hyrje.....	8
3. Metodologjia.....	10
4. Kuadri konceptual.....	11
5. Reagimi i Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19 në kontekstin e sigurisë publike	15
6. Reagimi i Shqipërisë ndaj pandemisë në kontekst rajonal dhe global	19
7. Reagimet e vendeve specifike ndaj pandemisë COVID-19	24
8. Reagimi ndaj pandemisë COVID-19 në kontekstin e të drejtave të njeriut	31
9. Konkluzionet	41
10. Rekomandime për situatat emergjente	43
11. Referenca	45
12. Shtojca 1: Intervistat dhe Fokus-Grupet e realizuara në Shqipëri.....	49

Lista e Figurave

Figura 1. Trajektorja e përhapjes së virusit COVID-19 në Shqipëri.....	16
Figura 2. Kapaciteti i kujdesit shëndetësor	20
Figura 3. Raste të reja të përditshme të konfirmuara me COVID-19 për një milion njerëz	21
Figura 4. Shkalla e fatalitetit të rasteve me COVID-19.....	22
Figura 5. COVID-19: Indeksi i nivelit të masave shtrënguese qeveritare	23
Figura 6. Trajektorja e Serbisë për pandeminë COVID-19.....	24
Figura 7. Trajektorja e Greqisë për pandeminë COVID-19	26
Figura 8. Trajektorja e Sllovenisë për pandeminë COVID-19.....	27
Figura 9. Reagimet krahasuese të pyetjes: Në cilin prej burimeve të mëposhtme të informacionit keni më shumë besim në lidhje me saktësinë e informacionit që jepet për koronavirusin?	29

Lista e Termave dhe Përkufizimeve

ALL	Lek shqiptar
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
BE	Bashkimi Evropian
CoE	Këshilli i Evropës
COVID-19	Sëmundja Coronavirus që u shfaq në 2019
CSSE	Qendra për Shkencën dhe Inxhinierinë e Sistemeve në Universitetin Johns Hopkins
ERTV	Edi Rama televizion: Youtube dhe media sociale
IDEA	Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Ndhinë Zgjedhore/SP Instituti i Studimeve Politike
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
OxCGRT	Gjurmuesi i masave të qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

1. Përmbledhje Ekzekutive

Për shkak të pandemisë COVID-19, qytetarëve në të gjithë botën ju rrezikua e drejta për të jetuar. Në kontekstin shqiptar, një fatkeqësi natyrore siç është pandemia COVID-19 përbën kërcënim për sigurinë publike (kombëtare), pasi paraqet rreziqe ndaj sigurisë dhe mirëqenies së popullatës. Në këtë raport, siguria publike dhe siguria kombëtare janë koncepte që përdoren në mënyrë të njëjtë për t'iu referuar sigurisë më të gjerë të shoqërisë dhe anëtarëve të saj. Kushtetuta e Shqipërisë (nenet 37, 45, 173, 174 dhe 175) i referohet sigurisë publike për të justifikuar vendosjen e masave të jashtëzakonshme, për arsye se vendi duhet të mbrohet në raste të "gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore" (Neni 170: 1). Pandemia ka demonstruar se fusha që përfshihet në kuadrin e sigurisë kombëtare, duhet të zgjerohet, me qëllim që të përfshijë kërcënime më gjithëpërfshirëse të sigurisë siç janë krizat globale të mjedisit dhe shëndetit publik.

Për të frenuar përhapjen e një fatkeqësie natyrore si pandemia COVID-19, qeveria është e autorizuar të marrë masa të jashtëzakonshme që do të kufizonin përkohësisht të drejta të veçanta të njeriut. Sidoqoftë, qeveritë demokratike duhet të mbajnë përgjegjësi për çdo shkëmbim apo kompromis që bëhet në lidhje me të drejtat e njeriut dhe liritë civile dhe që autorizohen në emër të sigurisë publike (kombëtare). Duke reflektuar për këto çështje, ky studim kontekstualizon dhe krahason reagimin e Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19 brenda një kuadri të sigurisë kombëtare dhe perspektivave të të drejtave të njeriut. Reagimi i qeverisë ndaj pandemisë COVID-19 në Shqipëri është krahasuar me masat e marra nga shtete të veçanta në rajonin e Ballkanit: Serbia dhe Maqedonia e Veriut (regjime hibride), Sllovenia dhe Greqia (demokraci të konsoliduara).

Për të hulumtuar supozimet e sigurisë kombëtare për masa të tilla të jashtëzakonshme, bazuar në të dhëna empirike, ne shqyrtojmë nëse masat e sigurisë që u zbatuan, kufizuan përhapjen e pandemisë COVID-19 në Shqipëri. Për më tepër, ne iu referohemi të dhënave parësore të përfituara nga intervistat e strukturuar, përmes të cilave tentojmë të kuptojmë nivelin e pranimit të këtyre masave qeveritare nga ana e publikut. Për të hedhur dritë mbi reagimin e Shqipërisë ndaj pandemisë në kontekstin e të drejtave të njeriut, ky raport bazohet në katër parime themelore demokratike: ligjshmëria; kuadri i kufizuar kohor për masat emergjente; domosdoshmëria, shpërndarja e pushtetit përmes veprimeve legislative dhe gjyqësore si dhe kontrolleve mbi veprimet ekzekutive të ndërmarra gjatë gjashtë muajve të parë të pandemisë. Brenda këtyre katër parimeve themelore demokratike, qeveritë mund të shkelin përkohësisht të drejtat e njeriut, në mënyrë që të përballen me kërcënimin e sigurisë kombëtare, i cili u shfaq si pasojë e pandemisë. Analiza jonë tregon se Shqipëria plotësoi parimet e ligjshmërisë dhe kuadrin të caktuar kohor për masat emergjente, si dhe plotësoi pjesërisht parimet e domosdoshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimet ekzekutive.

Kur Shqipëria vendoset në kontekstin rajonal, mund të vërehen disa modele. Gjatë periudhës së masave të jashtëzakonshme, qeveria shqiptare miratoi ligje që kufizuan përhapjen e COVID-19 brenda territorit të saj. Shumica e vendeve zbatuan masa të përkohshme të karantinës, të cilat kufizuan disa të drejta të njeriut. Në veçanti, si pasojë e reagimit të qeverive ndaj pandemisë COVID-19, u mohuan në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e lirisë së lëvizjes dhe organizmit të tubimeve. Për sa i përket zbatimit të masave emergjente gjatë ditëve të para të pandemisë, demokracitë hibride me institucione të dobëta krijuan rreziqe të caktuara për demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Në këto raste, ndërsa ekzekutivi zgjeroi pushtetin e tij, legjislativi dhe gjyqësori kufizuan kryesisht kapacitetet e tyre për të mbikqyrur masat dhe zbatimin e tyre. Kështu, regjimet hibride si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia nuk i përmbushën plotësisht katër parimet e ligjshmërisë, kuadrit të kufizuar kohor për masat emergjente, domosdoshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimet ekzekutive. Nga ana tjetër, Greqia, një demokraci e konsoliduar, plotësoi katër parimet, ndërsa Sllovenia, gjithashtu një demokraci e konsoliduar, plotësoi tre nga parimet përfshirë ligjshmërinë, kuadrin e kufizuar kohor për masat emergjente dhe shpërndarjen e pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimet ekzekutive, ndërsa plotësoi pjesërisht parimin e domosdoshmërisë.

Kjo analizë vë në pah implikime të rëndësishme për konsolidimin e demokracisë në një periudhë afatgjatë. Ajo tregon se në raste emergjencash kombëtare - siç është pandemia - ekziston rreziku i përdorimit të forcës së tepruar që realizohet në emër të sigurisë publike. Në mënyrë që të garantohet mbrojtja e të drejtave të njeriut gjatë periudhave të tilla, demokracitë hibride në veçanti, duhet të përqendrohen në forcimin e institucioneve dhe procedurave të tyre demokratike, me qëllim që të parandalojnë tejkalimin e kufijve të paravendosur për ushtrimin e pushtetit ekzekutiv dhe të sigurojnë zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

2. Hyrje

Pandemia COVID-19 ishte një emergjencë e shëndetit publik që kërcënoi jetën e qytetarëve në të gjithë botën. Qeveritë reagues përmes zbatimit të masave të ndryshme dhe shumë prej tyre - për të ndaluar ose kufizuar përhapjen e virusit dhe për të mbrojtur jetën e qytetarëve - miratuan ligje të jashtëzakonshme. Ligje të tilla emergjente kufizuan liritë dhe të drejtat, të tilla si liria e lëvizjes, fjalës, punës, ndër të tjera, në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë publike. A ishin proporcionale masa të tilla në raport me rreziqet? Çfarë mësimesh mund të nxirren nga krahasimi i reagimeve të qeverive ndaj një krize kaq të jashtëzakonshme për shëndetin publik? Si mund të zbatohen këto njohuri për emergjencat e ardhshme?

Meqenëse virusi COVID-19 kërcënoi seriozisht jetën e qytetarëve, mbrojtja e shëndetit publik u konsiderua pjesë e sigurisë publike (kombëtare). Në këtë raport, konceptet e sigurisë publike dhe sigurisë kombëtare përdoren në mënyrë të njëjtë për t'iu referuar sigurisë më të gjerë të shoqërisë dhe anëtarëve të saj. Për të kufizuar kërcënimin e një fatkeqësie natyrore si pandemia COVID-19, qeveria është e autorizuar të marrë masa të jashtëzakonshme që kufizojnë përkohësisht të drejta të veçanta të njeriut. Ky studim shqyrton nëse masat emergjente ishin të justifikuara në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe të drejtave të njeriut të qytetarëve. Në lidhje me liritë civile dhe të drejtave të njeriut, qeveritë duhet të mbajnë përgjegjësi për çdo shkëmbim dhe kompromis që autorizohet në emër të sigurisë publike (kombëtare). Duke reflektuar për këto çështje, ky studim kontekstualizon dhe krahason reagimin e Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19 brenda kuadrit të sigurisë kombëtare dhe perspektivave të të drejtave të njeriut.

Për shkak se pandemia COVID-19 sfidoi aspektet e sigurisë kombëtare në çdo shtet, qeveritë vendosën kufizime mbi të drejtat e njeriut. Për të hulumtuar reagimin e Shqipërisë në drejtim të sigurisë publike (kombëtare), ne shqyrtojmë të dhëna për shkallën, sipas së cilës masat kufizuese të ndërmarra nga qeveria kufizuan përhapjen e virusit dhe mbrojtën shëndetin publik. Për të shqyrtuar reagimin e Shqipërisë në këndvështrimin e të drejtave të njeriut, ky raport bazohet në katër parime themelore demokratike: ligjshmëria; kuadri i kufizuar kohor për masat emergjente; domosdoshmëria; shpërndarja e pushtetit përmes veprimeve legjislative dhe gjyqësore si dhe kontrollin mbi veprimet ekzekutive të ndërmarra gjatë gjashtë muajve të parë të pandemisë. Ky studim ofron gjetje dhe rekomandime në lidhje me tensionin ndërmjet mbrojtjes së sigurisë publike (kombëtare) dhe së drejtës për të jetuar përkundrejt të drejtave të tjera të njeriut në situatën e veçantë të krijuar nga pandemia COVID-19. Ne krahasojmë gjithashtu reagimin qeveritar ndaj pandemisë COVID-19 në Shqipëri me masat e marra nga shtete të veçanta në rajonin e Ballkanit: Serbia dhe Maqedonia e Veriut (regjime hibride), Sllovenia dhe Greqia (demokraci të konsoliduara).

Konkretisht, ky raport trajton pyetjet e mëposhtme:

➤ Deri në çfarë mase mund të anashkalohej mbrojtja, respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut për të mundësuar mbrojtjen e qytetarëve? A u miratuan masat emergjente në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit? Cilat të drejta themelore u mohuan nga ligjet dhe praktikatat e miratuara nga qeveria? Si mund të përcaktohet koncepti i sigurisë kombëtare (publike) në raste emergjencash dhe çfarë përfshin ai?

➤ Deri në çfarë mase mund të zbatohen masat kufizuese të sigurisë të miratuara për mbrojtjen e qytetarëve në mënyrë proporcionale dhe të ekuilibruar që siguron zbatimin e të drejtave të njeriut? A u përdorën këto masa sigurie si një alternativë e fundit dhe u konsideruan më pak kufizuese nga të gjitha opsionet që mund të ishin zbatuar? Si ka ndryshuar pushteti i institucioneve të veçanta gjatë kësaj situatë emergjente? Së fundmi, cili është rreziku i mundshëm i këtyre veprimeve përkunder konsolidimit të institucioneve demokratike në një periudhë afatgjatë në këto vende?

3. Metodologjia

Ky raport bazohet në hulumtime rigoroze krahasuese të të dhënave parësore dhe dytësore si dhe në kërkime empirike cilësore të përqendruara në reagimin e qeverisë ndaj pandemisë COVID-19 në një grup të përzgjedhur vendesh. Raporti krahason reagimin qeveritar ndaj pandemisë COVID-19 në Shqipëri me masat e marra nga shtete të veçanta në rajonin e Ballkanit: Serbia dhe Maqedonia e Veriut (regjime hibride), Sllovenia dhe Greqia (demokraci të konsoliduara).

Analiza jonë përfshin të dhëna sasiore dhe cilësore nga burimet e mëposhtme ndërkombëtare: Gjurmuesi i masave së qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit (OxCGRT), Freedom House, Monitori Botëror i Ndikimit të COVID-19 në Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut – realizuar nga organizata IDEA, Gjurmuesi i Demokracisë dhe Pandemisë të Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), dhe Burimet e Këshillit të Evropës - Gjurmuesi i Traktateve. Kërkimet cilësore në Shqipëri u përqendruan në perspektivat e grupeve të interesit për reagimin e qeverisë gjatë periudhës së emergjencës, veçanërisht masat e ndërmarra nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për të realizuar këto objektiva, u zhvilluan 7 intervista gjysmë të strukturuar dhe dy fokus-grupe me përfaqësues të OJF-ve, ekspertë të shëndetit publik, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe mediave, duke përdorur teknikën e kampionimit të qëllimshëm. Qëllimi i kësaj metodologjie është të kuptuarit e kushtetutshmërisë dhe proporcionalitetit të masave emergjente përkundër mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pyetjet e intervistave dhe fokus-grupeve u përqendruan gjithashtu në nivelin e transparencës së politikave qeveritare, pjesëmarrjen në diskutime të ekspertëve dhe grupeve të ndryshme të interesit gjatë procesit të hartimit të politikave dhe reagimit publik ndaj masave emergjente. Janë analizuar edhe aktet ligjore të shpallura nga qeveria shqiptare gjatë periudhës mars-shtator 2020. Ndërsa në fokusin kryesor të këtij studimi janë gjashtë muajt e parë të pandemisë (mars-gusht 2020), evidenca krahasuese paraqiten në fazën e fundit të krizës (shtator-dhjetor 2020). Intervistat dhe fokus-grupet u zhvilluan në gjuhën shqipe, dhe të dhënat cilësore u përkthyen më pas në anglisht. Raporti përfundimtar u shkrua dhe u redaktua në anglisht, dhe më pas u përkthye në shqip.

4. Kuadri konceptual

Pandemia COVID-19 ndikoi në shëndetin e popullatës në nivel global dhe në sistemet politike të vendeve ku u përhap kjo pandemi. Për të adresuar rrezikun për shëndetin e popullatës si pjesë e mbrojtjes së sigurisë publike (kombëtare), qeveritë morën masa të jashtëzakonshme. Në kontekstin shqiptar dhe botëror, një fatkeqësi natyrore siç është pandemia COVID-19 përbën kërcënim të sigurisë publike (kombëtare), pasi paraqet rreziqe për sigurinë dhe mirëqenien e popullatës. Në këtë raport, siguria kombëtare dhe siguria publike përdoren në mënyrë të njëjtë për t'iu referuar sigurisë më të gjerë të shoqërisë dhe anëtarëve të saj. Kushtetuta e Shqipërisë (nenet 37, 45, 173, 174 dhe 175) i referohet sigurisë publike për të justifikuar vendosjen e masave të jashtëzakonshme për të mbrojtur vendin "për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore" (Neni 170: 1). Pandemia ka demonstruar se fusha që përfshihet në kuadrin e sigurisë kombëtare, duhet të zgjerohet, me qëllim që të përfshijë kërcënime më gjithëpërfshirëse të sigurisë siç janë krizat globale të mjedisit dhe shëndetit publik. Për të frenuar përhapjen e një fatkeqësie natyrore si pandemia COVID-19, qeveria është e autorizuar të marrë masa të jashtëzakonshme që do të kufizonin përkohësisht të drejta të veçanta të njeriut.

Shumica e qeverive kanë marrë masa të ashpra për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike, ndërkohë që numri i të infektuarve me COVID-19 është rritur. Kjo sugjeron që ekziston njëfarë përputhshmërie ndërkombëtare rreth pritshmërive të publikut për masat mbrojtëse të marra nga qeveria, pasi bota u përball me një krizë të paprecedentë ndaj shëndetit publik. Sipas një studimi gjithëpërfshirës mbi trendet demokratike globale para dhe gjatë pandemisë COVID-19 të kryer nga Instituti Ndërkombëtar për Asistencë Demokratike dhe Zgjedhore (International Institute for Democratic and Electoral Assistance - IDEA), 59 për qind e vendeve të botës shpallën gjendjen e jashtëzakonshme, e cila kufizonte liritë themelore civile, të tilla si liria e lëvizjes dhe e organizmit të tubimeve (IDEA, 2020, 1). Për më tepër, ky studim arriti në përfundimin se 61 për qind e vendeve zbatuan masa problematike nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut; masa të tilla shkelnin standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sepse ishin "jo-proporcionale, të paligjshme, të papërcaktuara ose të panevojshme në lidhje me kërcënimin shëndetësor" (IDEA, 2020, 1). Ndërsa pandemia COVID-19 përfaqësonte një sfidë të paprecedentë për qeveritë demokratike, standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë të rrënjosura dhe duhet të respektohen edhe gjatë emergjencave të zgjatura.

Shumë vende shtynë në kohë ose modifikuan zhvillimin e zgjedhjeve, gjë që kufizoi proceset zgjedhore si tubimet dhe votimet personale në mënyrë fizike, që mund të shkaktonin përhapjen e mëtejshme të virusit COVID-19. Vendet që nuk shpallën gjendjen e jashtëzakonshme, zbatuan – prapëseprapë - masat mbrojtëse që nevojiteshin për të luftuar virusin, të tilla si masat e izolimit. Përveç kësaj, për të rekomanduar masa individuale të higjienës (veçanërisht larjen e duarve dhe vënien e maskave të fytyrës) dhe izolimin fizik (distancimin shoqëror), qeveritë realizuan fushata të informimit publik. Të dhënat sasiore

sugjerojnë se masat e jashtëzakonshme të izolimit të popullatës reduktuan nivelin e infeksionit dhe vdekshmërisë në vendet ku u veprua më shpejt për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 dhe ku qytetarët që qëndronin në shtëpi patën mbështetje ekonomike nga qeverisë (Bonardet et al., 2020). Aplikimi i masave të izolimit për një kohë të gjatë nuk është i qëndrueshëm nga perspektivat ekonomike dhe sociale, kështu që qeveritë lehtësojnë kufizimet pasi frenohet përhapja e virusit. Në të kundërt, qeveritë mund të rrisin përsëri nivelet e kufizimeve.

Demokracitë që angazhohen për zbatimin e ligjit, duhet të respektojnë kornizën ligjore kushtetuese të vendit të tyre kur aplikojnë kufizime gjatë një emergjence të tillë si pandemia. Ekziston shqetësimi i konsiderueshëm se vendet me demokraci të brishta, të cilave iu mungojnë institucionet e konsoliduara, kanë më shumë gjasa të shfaqin kërcënime serioze ndaj demokracisë, përfshirë miratimin e masave që shkelin standardet e të drejtave të njeriut si rezultat i pandemisë. Në përgjithësi, masat e aplikuara në kuadër të gjendjes së jashtëzakonshme që paraqesin rreziqe për demokracinë përfshijnë: mungesën e kontrollit të mjaftueshëm nga legjislativi ose gjyqësori për vendimet e ekzekutivit; përqendrimin e pushtetit në degë ekzekutive të qeverisë; dhe marrjen e masave shoqërore që shkojnë përtej kufizimit të përhapjes së virusit (veçanërisht masat që dëmtojnë mediat dhe/ose sjellin përdorimin e tepruar të forcës ndaj qytetarëve gjatë zbatimit të kufizimeve të emergjencës) (IDEA, 2020). Siç do të diskutojmë në analizën empirike të mëposhtme, në demokraci hibride si Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut¹, këto rreziqe janë vërejtur gjatë reagimit fillestar të qeverive ndaj pandemisë COVID-19.

Kufizimet më të zakonshme të vendosura gjatë pandemisë kanë qenë shkeljet e lirisë së lëvizjes dhe organizimit të tubimeve. Raporti global i realizuar nga IDEA International (2020) thekson zhvillimet shqetësuese në lidhje me lirinë e shprehjes, integritetin e medias dhe sigurinë personale. Për më tepër, gjysma e zgjedhjeve të planifikuara në periudhën shkurt - dhjetor 2020 u shtynë, duke treguar një fushë tjetër të shkeljes së mundshme të të drejtave dhe proceseve demokratike (IDEA, 2020).

Manuali i Këshillit të Evropës (CoE, 2020a) për respektimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut gjatë periudhave të gjendjes së jashtëzakonshme ofron një kornizë të rëndësishme, përmes të cilës vlerësohet ligjshmëria dhe proporcionaliteti i reagimit ndaj pandemisë COVID-19 në vendet anëtare. Këshilli i Evropës pranon se, duke marrë masa kufizuese për të adresuar COVID-19, shtetet mund të vendosin të evitojnë (pezullojnë përkohësisht) mbrojtjen e të drejtave të veçanta; megjithatë, kufizimet duhet të jenë gjithmonë proporcionale me kërcënimin dhe të kufizuara në kohë.

¹Freedom House përdor kategorinë "Pjesërisht të Lira" për t'iu referuar demokracive hibride, në të cilat rregullat demokratike të lojës nuk janë të konsoliduara. Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë të cilësuar si Regjime Pjesërisht të Lira; për më shumë informacion, shih: <https://freedomhouse.org/explore-the-map?type=fiw&year=2020>.

Pandemia COVID-19 paraqiti sfida të mëdha për shëndetin publik të popullatave në çdo shtet, gjë që përbënte kërcënim për sigurinë publike (kombëtare). Në këtë mënyrë justifikohet vendosja e disa kufizimeve të përkohshme, proporcionale dhe kushtetuese të të drejtave të njeriut. Sipas Këshillit të Evropës, "Neni 5.1 (e) [i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] specifikon se parandalimi i përhapjes së sëmundjeve infektive është një nga arsyet, për të cilat një person mund të privohet nga liria e tij/saj. Para marrjes së masave të tilla, parashikohet që shtetet të kontrollojnë ekzistencën e një baze ligjore përkatëse dhe të marrin në konsideratë nëse masat që arrijnë deri në privimin e lirisë, janë të domosdoshme kundër ndonjë alternative më pak të ashpër"(CoE, 2020a, 6).²

Nëse vendet anëtare vendosin të marrin masa emergjente që kufizojnë përkohësisht të drejtat e njeriut, Këshilli i Evropës (2020a) përcakton se shtetet duhet të ndjekin katër parime kryesore demokratike ligjore. Së pari, parimi i *ligjshmërisë* nënkupton që sundimi i ligjit duhet të ketë përparësi edhe gjatë një emergjence. Shtetet duhet të ndjekin dispozitat kushtetuese kur miratojnë legjislacion të ri dhe dekrete ekzekutive. Ligjet e reja të miratuara gjatë pandemisë duhet të jenë në përputhje me kushtetutën e vendit dhe me standardet ndërkombëtare, si dhe duhet të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (CoE, 2020a, 2). Parlamenti duhet të garantojë mbikëqyrjen e nevojshme të legjislacionit për emergjencat.

Parimi i dytë që zbatohet gjatë pandemisë, është *kohëzgjatja e kufizuar* e gjendjes së jashtëzakonshme dhe masat e saj. Pushteti që marrin qeveritë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme për të miratuar dekrete me forcën e ligjit, duhet të jetë i përkohshëm. Parlamentet duhet të vendosin nëse dhe në çfarë kushtesh do të ishte e nevojshme zgjatja e masave emergjente. Vazhdimi i pacaktuar i kompetencave në një gjendje të jashtëzakonshme bie ndesh me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe parimet demokratike.

Sipas Këshillit të Evropës, parimi i tretë i *domosdoshmërisë* përcakton që masat emergjente duhet të përbushin qëllimet e tyre me sa më pak ndryshime të mundshme të rregullave dhe procedurave normale demokratike. Për më tepër, masat duhet të jenë sa më të kufizuara në fushën e tyre të veprimit dhe nuk duhet të krijojnë një situatë ku "legjislativi i jep ekzekutivit *carte blanche* (liri të plotë)" (CoE, 2020a, 4). Kështu, ekzekutivi, ndërsa mund të miratojë dekrete për emergjencën, nuk duhet të realizojë reforma të gjera themelore ligjore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme që mund të çojnë në abuzim të pushtetit.

Parimi i katërt që shtetet duhet të zbatojnë gjatë një emergjence, i referohet *shpërndarjes së kompetencave dhe kontrolleve mbi veprimin ekzekutiv*. Gjatë një krize të tillë si pandemia, ekzekutivi duhet të jetë në gjendje të veprojë

²Këshilli i Evropës përcakton qartë se disa të drejta themelore nuk mund të shkelen; për shembull, "e drejta për të jetuar - përveçse në kontekstin e ligjit të luftës (neni 2), ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës dhe dënimit (neni 3), ndalimi i skllavërisë dhe robërisë (neni 4 § 1) dhe rregulli i 'pandëshkueshmërisë pa ligj' (neni 7)". (CoE, 2020a, 2).

shpejt për t'u përballur me situatën dhe për të mbrojtur shëndetin publik në interes të sigurisë kombëtare. Në këtë kontekst, autoritetet qendrore mund të anashkalojnë kompetencat e autoriteteve lokale dhe rajonale, në mënyrë që të koordinojnë reagimin ndaj krizës derisa situata të zgjidhet. Nga ana tjetër, parlamentet duhet të mbikëqyrin ekzekutivin duke verifikuar dhe garantuar se masat e emergjencës janë të justifikuara. Shkrija e Parlamentit gjatë emergjencës nuk është masa e duhur. Në mënyrë të ngjashme, gjyqësori - veçanërisht Gjykata Kushtetuese - duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë kufizimet për të drejtat e njeriut të paraqitura gjatë emergjencës. Së fundmi, Këshilli i Evropës paralajmëron se mbajtja e zgjedhjeve dhe referendumeve gjatë një emergjence do të ishte problematike, për shkak të kufizimeve të vendosura për zhvillimin e fushatave (CoE, 2020a, 4).

5. Reagimi i Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19 në kontekstin e sigurisë publike



Në mënyrë që të analizojmë reagimin e Shqipërisë për mbrojtjen e sigurisë publike gjatë masave emergjente, iu referohemi të dhënave për të kuptuar nëse masat kufizuan përhapjen e COVID-19. Për më tepër, ne shqyrtojmë të dhënat dytësore nga sondazhet dhe ato parësore të marra nga intervistat dhe fokus grupet, me qëllim që të kuptojmë nivelin e pranimin të masave qeveritare nga publiku. Meqenëse COVID-19 është pandemi globale, ne krahasojmë gjithashtu masat dhe treguesit shëndetësorë të Shqipërisë me disa vende në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Fillimisht Shqipëria reagoi ndaj kërcënimit të sigurisë kombëtare që u shkaktua nga virusi COVID-19 duke përdorur masa të izolimit social. Për sa i përket intervalit kohor të reagimit të qeverisë, rasti i parë me COVID-19 u zbulua në Shqipëri në 9 mars 2020. Më 11 mars, Organizata Botërore e Shëndetësisë³ e emërtoi COVID-19 pandemi globale dhe Shqipëria vendosi masa të pjesshme të izolimit. Për të fuqizuar rregullat e izolimit, qeveria mobilizoi ushtrinë gjatë periudhës 9 - 15 mars. Në bazë të neneve 170 - 175 të Kushtetutës, më 24 mars Këshilli i Ministrave⁴ shpalli Gjendjen e Fatkeqësisë Natyrore për 30 ditë, duke kufizuar trafikun ajror, tokësor dhe detar, duke pezulluar sistemin arsimor dhe duke vendosur procedura të karantinës dhe vetë-izolimit – ndër masa të tjera. Më 21 prill, parlamenti shqiptar miratoi propozimin për të zgjatur Gjendjen e Fatkeqësisë Natyrore⁵ deri më 23 qershor.⁶ Për të adresuar impaktin ekonomik të shkaktuar nga pandemia, më 25 mars qeveria shqiptare ofroi mbrojtje sociale dhe ekonomike, duke përfshirë dy paketa me ndihma për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha⁷, subvencione dhe shpërndarje të ushqimit dhe programe të subvencionuara për personat që humbën përkohësisht vendin e punës.⁸ Ndihma u shpërnda gjerësisht dhe media nuk ka raportuar raste të abuzimit me ndihmën e dhënë nga ana e qeverisë gjatë pandemisë.

Izolimi i rreptë gjatë aplikimit të masave emergjente të Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore në Shqipëri kufizoi përhapjen e virusit dhe numrin e viktimave. Sipas Johns Hopkins Coronavirus Resource Center, deri më 31 janar 2021, për shkak të pandemisë COVID-19, në Shqipëri kishin humbur jetën 49 persona për 100,000 qytetarë, një normë më e ulët në krahasim me

³<https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---11-march-2020>

⁴<https://rm.coe.int/ij9020c-tr-005-231-en-annex-1/16809e0fe7>

⁵Vendimi Nr. 243, datë 24.3.2020 për Deklaratën e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore, faqe 1

⁶<https://qzb.gov.al/eli/vendim/2020/04/23/18>

⁷<https://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/>. See also https://assets.ev.com/content/dam/ev-sites/ev-com/en_al/generic-content/pdf/ev-government-support-package-albania-and-kosovo.pdf, pg. 6.

⁸<https://tracker.wfd.org/country/albania/>

Greqinë (55 vdekje), Slloveninë (172 vdekje), Serbinë (58 vdekje) dhe Maqedoninë e Veriut (138 vdekje).⁹

Në Figurën 1 (më poshtë) krahasohen vdekshmëritë ditore nga COVID-19 me shkallën e ashpërsisë së reagimit të qeverisë në Shqipëri. Indeksi i ashpërsisë së masave qeveritare është llogaritur në bazë të indikatorëve të mëposhtëm: mbyllja e shkollave; mbyllja e vendeve të punës; anulimi i eventeve publike; kufizimi i tubimeve publike; pezullimi i transportit publik; detyrimi për të qëndruar në shtëpi; fushatat e informimit publik; kufizimi i lëvizjeve të brendshme; dhe kontrollet ndërkombëtare të udhëtimit.¹⁰ Ne vërejmë reduktim të numrit të vdekjeve gjatë periudhës së Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore në prill - maj 2020, ndërsa periudha shtator – dhjetor 2020 shënoi numrin më të lartë të vdekjeve në nivel ditor. Kështu, të dhënat tregojnë se masat fillestare kufizuese të izolimit ulën shkallën e transmetimit të sëmundjes dhe vdekshmërisë. Për shkak të rritjes së numrit të vdekjeve nga COVID-19 gjatë dhe pas fazës së izolimit, qeveria ndryshoi kufizimet, por nuk miratoi një izolim tjetër në shkallë të gjerë.




Figura 1. Trajektorja e përhapjes së virusit COVID-19 në Shqipëri

Burimi: Gjurmuesi i masave së qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit (OxCGRT). <https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk/>

Qeveria, duke u rezervuar për marrjen e masave kufizuese gjatë periudhës shtator – dhjetor 2020, nuk vendosi një izolim tjetër, pavarësisht rritjes së

⁹<https://coronavirus.jhu.edu/data/mortality>. Duhet t'i interpretojmë këto të dhëna me një dozë të caktuar skepticizmi, pasi mund të ketë raportime të ulëta të vdekjeve nga qeveritë, veçanërisht në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut ku realizoheshin më pak teste për person.

¹⁰<https://ourworldindata.org/coronavirus>.

infeksioneve dhe vdekjeve nga COVID-19. Më 1 qershor 2020, me Urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19", përmes një plan-veprimi, kufizimet më të rrepta u hoqën.¹¹ Në vend të një bllokimi të plotë, qeveria shqiptare vendosi të theksonte masat higjienike kufizuese dhe përdorimin e detyrueshëm të maskave të fytyrës. Në lidhje me zbatimin e këtyre masave, të intervistuarit vërejnë se Shqipëria ndoqi shembujt e vendeve të tjera. Për shembull, të intervistuarit vunë në dukje sa vijon:

Shqipëria nuk ndoqi një qasje krejtësisht individuale dhe unike, por u fokusua në administrimin e situatës, duke imituar modele të vendeve të tjera. Kryeministri ndoqi shumë shpesh shembujt e të tjerëve, ndërsa vendosi marrjen e masave ose kufizimeve të veçanta.¹² Të paktën, në krahasim me fqinjët, qeveria nuk shfaqti ndonjë model të ndryshëm menaxhimi.¹³

Për më tepër, ashtu si në vendet e tjera gjatë kësaj periudhe, ka shumë të ngjarë që qeveria shqiptare shmangu vendosjen e një izolimi të ri për shkak të paaftësisë së saj për të përballuar ndikimet negative ekonomike të kufizimeve,¹⁴ duke përfshirë borxhin e rritur kombëtar pas emetimit të një Eurobond-i në shumën 650 milion euro.¹⁵

Në Tabelën 1 (më poshtë) krahasohen numri i përgjithshëm të personave të infektuar, si dhe shërimet dhe vdekjet për shkak të COVID-19 në faza të ndryshme të pandemisë me masa të ndryshme të marra nga qeveria shqiptare. Të dhënat tregojnë se masat e izolimit gjatë situatës emergjente kufizuan përhapjen e virusit dhe numrin e vdekjeve. Rritja e numrit të testeve pas masave të bllokimit emergjent u shoqërua me rritje të zbulimit të personave të infektuar me COVID-19 gjatë periudhës shtator - dhjetor. Numri i infeksioneve dhe vdekjeve nga COVID-19 ishte më i lartë në këtë periudhë - krahasuar me periudhën mars - qershor.¹⁶

¹¹ <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/01/WFD-Report-Follow-the-Money-Shendetesi-Shqip-FINAL.pdf>, pg. 12

¹² Intervistë me ekspertë të çështjeve të sigurisë, 2020

¹³ Intervistë me ekspertë të çështjeve të sigurisë, 2020

¹⁴ <http://pubdocs.worldbank.org/en/254111588143425920/RER-17-Setting-the-Stage-ALB.pdf>

¹⁵ <https://www.intellinews.com/albania-issues-650mn-eurobond-with-3-65-coupon-185059/#:~:text=Albania%20has%20issued%20a%20seven,a%20coupon%20rate%20of%203.65%25>

¹⁶ Sipas të dhënave të marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe të përpunuar nga "Monitor", "grupmosha me vdekshmërinë më të lartë nga COVID-19 është 60-69 vjeç, e ndjekur nga grupmosha 70-79 vjeç dhe grupmosha mbi 80 vjeç për periudhën mars - shtator. Megjithatë, ka një rritje të konsiderueshme të numrit të vdekjeve nën moshën 60 vjeç, e cila më 28 korrik përbënte 23% të totalit, nga 8.7% në mes të prillit". <https://www.monitor.al/gati-10-e-vdekjeve-nga-covid-19-ne-vend-nuk-kishin-semundje-shoqeruese-mosha-mesatare-zbret-ne-66-8-vjec/>

	Pacientë të testuar	Testime pozitive	Aktualisht të shtruar në spital	Pacientë të shëruar	Raste aktive	Numri total i vdekJeve	Masa administrative
Deri në 23 mars, 2020	853	104	49	5	99	4	Urdhri nr. 193, datë 20.3.2020 "Për Mbylljen dhe Kufizimin e Lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë.
Deri në 1 qershor, 2020	14824	1143	28	877	233	33	Urdhër nr. 351, datë 29.5.2020, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19".
Deri në 22 tetor, 2020	114381	18556	258	10395	7390	469	Udhëzimi nr. 1163/1, datë 13.10.202, miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik "Për përdorimin e detyrueshëm të maskave jashtë shtëpisë".
Deri në 14 janar, 2021	299560	65994	271	39246	25487	1261	Udhëzimi nr. 1163/1, datë 13.10.202 vijon

Tabela 1. Rastet me COVID-19 dhe veprimet e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.¹⁸

¹⁷<http://open.data.al/covid-19/>

¹⁸https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/01/WFD-Report_Follow-the-Money_Shendetesi_Shqip-FINAL.pdf, faqe 12

6. Reagimi i Shqipërisë ndaj pandemisë në kontekst rajonal dhe global



Në mënyrë që të kontekstualizojmë reagimin e Shqipërisë ndaj pandemisë në një perspektivë krahasuese, në këtë seksion diskutohen gjetjet e përfituara nga një shqyrtim i reagimeve të vendeve fqinje. Meqenëse shumica e vendeve përballen me të njëjtin kërcënim ndaj shëndetit publik, shqyrtimi i ngjashmërive dhe kontrasteve në

modelet e reagimit ofron informacion të rëndësishëm për pyetjet tona kërkimore në lidhje me masat e shëndetit publik të miratuara në emër të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut gjatë pandemisë. Vendet e përzgjedhura për krahasim me Shqipërinë në nivel rajonal përfshijnë Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut (regjime hibride) si dhe Slloveninë dhe Greqinë (regjimet demokratike të konsoliduara).

Masat e emergjencës të marra nga qeveria shqiptare mund të shpjegohen përmes pranimit nga qeveria dhe publiku se infrastruktura shëndetësore ishte e dobët dhe do të mbingarkohej nga rritja e shpejtë e niveleve të infeksionit me COVID-19. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, institucionet e shëndetit publik janë lënë pas dore nga qeveritë përkatëse. Për më tepër, për shkak të mungesës së investimeve dhe migrimit të profesionistëve të kualifikuar, këto institucione nuk arrijnë të ushtrojnë kapacitetet e nevojshme (Beiber et al., 2020). Neglizhenca sistematike ndaj sistemeve shëndetësore në këto vende nënkupton se spitalet kishin vështirësi në trajtimin e shumë rasteve me COVID-19, gjë që rriti vigjilencën e qeverive për të zbatuar masa kufizuese dhe ndëshkime të ashpra për të parandaluar përhapjen e shpejtë të virusit. Sipas intervistave në Shqipëri, “situata alarmante e epidemisë në Itali në mars rriti frikën nga COVID-19 dhe si rezultat, publiku u pajtua në një shkallë të konsiderueshme me masat e jashtëzakonshme që kufizuan disa të drejta të njeriut në favor të mbështetjes së të drejtës për të jetuar.”¹⁹ Kur shqyrtojmë të dhënat në lidhje me kapacitetin e kujdesit shëndetësor para emergjencës së krijuar nga COVID-19, arrijmë në përfundimin se infrastruktura shqiptare e kujdesit shëndetësor ishte e dobët. Shqipëria kishte më pak mjekë, infermierë dhe shtretër për person para emergjencës së krijuar nga COVID-19 sesa të gjitha vendet e referuara për krahasim. Reagimi paraprak i Shqipërisë ndaj pandemisë mund të kuptohet si masë parandaluese ndaj kërcënimit të virusit, gjë që do t'i krijonte mundësi qeverisë të përgatitej më mirë për këtë emergjencë. Të dhënat zyrtare të testimit gjatë periudhës së emergjencës tregojnë gjithashtu se në Shqipëri testet për person ishin të njëjtat si në Maqedoninë e Veriut, por më të ulëta se në vendet e tjera (Figura 2).

¹⁹Intervistë me ekspertë të fushës

Masat e jashtëzakonshme të izolimit në pranverën e vitit 2020 u krijuan mundësi qeverive të ndërtonin më shumë kapacitete të kujdesit shëndetësor në drejtim të shtretërve spitalorë në njësitë e kujdesit intensiv për pacientët e sëmurë rëndë me COVID-19, si dhe pajisjet mbrojtëse personale për stafin e spitalit. Për shembull, Shqipëria rriti numrin e shtretërve në njësitë së kujdesit intensiv nga 250-300 para pandemisë në 553 deri në korrik 2020. Greqia rriti numrin e shtretërve spitalorë në njësitë së kujdesit intensiv nga 565 para pandemisë në 1017 në prill 2020. Në Maqedoninë e Veriut, qeveria punoi me ushtrinë për të krijuar një spital të lëvizshëm me 130 shtretër në njësitë së kujdesit intensiv. Serbia krijoi një spital të përkohshëm në një terren sportiv në Beograd që përmbante 500 shtretër në njësitë së kujdesit intensiv. Sllovenia bleu ventilatorë dhe shtoi 300 shtretër të tjerë në njësitë së kujdesit intensiv – me qëllim që të fuqizonte infrastrukturën e saj shëndetësore.²⁰




Figura 2. Kapaciteti i kujdesit shëndetësor

Shënim: Të dhënat për mjekët, infermierët dhe shtretërit pasqyrojnë të dhënat para shfaqjes së pandemisë COVID-19. Burimi: Treguesit e Bankës Botërore. Të dhënat e testit COVID-19 janë javore për 1000 persona dhe pasqyrojnë mesataren gjatë pranverës 2020. Burimi: Monitorues i Kujdesit Shëndetësor. www.covid19healthsystem.org

²⁰www.covid19healthsystem.org

Ndërsa përhapja e virusit kërcënoi privimin e qytetarëve nga e drejta e tyre për jetën dhe u rrit në mënyrë eksponenciale duke rrezikuar shëndetin më të gjerë publik, qeveritë reagues duke marrë masa të ndryshme. Veçanërisht në ditët e para të pandemisë, kur rastet e fatalitetit ishin më të larta, qeveritë miratuan masa tepër kufizuese. Siç demonstron në Figurën 5, shumë nga reagimet më të rrepta qeveritare në Maqedoninë e Veriut, Greqi, Shqipëri, Slloveni dhe Serbi ndodhën gjatë periudhës mars - qershor 2020.




Figura 4. Shkalla e fatalitetit të rasteve me COVID-19

Burimi: Qendra për Shkencën dhe Inxhinierinë e Sistemeve (CSSE) në Universitetin Johns Hopkins.

Siç tregohet në Figurën 5, vendet ndoqën trende të ngjashme në shkallën e ashpërsisë së reagimeve qeveritare të matura nga disa tregues.

Këto tendenca tregojnë një rritje të përgjithshme të masave më të ashpra në muajt e parë të marsit deri në maj, me disa lehtësime të masave kufizuese gjatë qershorit deri në shtator, pasuar nga një rritje e ashpërsisë së masave gjatë tetorit deri në dhjetor pasi rastet e konfirmuara me COVID-19 vazhduan të shtoheshin.




Figura 5. COVID-19: Indeksi i nivelit të masave shtrënguese qeveritare²¹

Burimi: Gjurmuesi i masave së qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit (OxCGRT). <https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk/>

²¹Grupi kërkimor i Oksfordit nuk zotëronte të dhëna krahasuese për Maqedoninë e Veriut mbi matjet e masave shtrënguese qeveritare ndaj pandemisë.

7. Reagimet e vendeve specifike ndaj pandemisë COVID-19

Në seksionin në vijim diskutohen shkurtimisht trajektorët e reagimeve qeveritare të vendeve specifike të referuara në këtë studim ndaj pandemisë COVID-19.



Serbia




Figura 6. Trajektorja e Serbisë për pandeminë COVID-19

Burimi: Gjurmuesi i masave së qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit (OxCGRT). <https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk/>

Në Serbi, rasti i parë pozitiv me COVID-19 u identifikua më 6 mars. Deri më 13 mars, qeveria krijoi dy shtabe për menaxhimin e krizave: 1) Shtabi i Krizës për Luftën kundër Sëmundjes, i udhëhequr nga Kryeministri me anëtarësinë e ekspertëve mjekësorë dhe 2) Shtabi i Krizës për Ekonominë, bashkë-kryesuar nga Presidenti dhe Ministri i Financave. Më 15 mars, Serbia shpalli gjendjen të jashtëzakonshme: vendi u izolua, gjë që nënkuptonte edhe mbylljen e institucioneve arsimore. Serbia zbatoi nenin 20 të Kushtetutës së saj kur shpalli emergjencën (Tsifakis, 2020, 199). Më 10 prill, qeveria e Serbisë miratoi masa ekonomike dhe sociale për të mbështetur popullin gjatë karantinës. Parlamenti i dha fund gjendjes së jashtëzakonshme më 6 maj 2020. Më 21 qershor, u mbajtën zgjedhjet parlamentare. Parlamenti serb diskutoi rivendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme më 6 korrik 2020. Pas protestave të dhunshme me policinë në Beograd, qeveria fillimisht deklaroi se nuk do të impononte masa të tilla. Sidoqoftë, më 17 korrik, qeveria zbatoi përsëri masa emergjente (Tepavac & Brankovic, 2020b, 34).

Në përgjithësi, trajektorja e masave qeveritare të Serbisë në krahasim me vdekjet ditore nga COVID-19 (Figura 6) tregoi rritje të masave të ashpra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në mars deri në maj. Falë këtyre masave, u reduktuan vdekjet ditore dhe u kufizua përhapja e infeksionit. Qeveria lehtësoi për një kohë të shkurtër masat kufizuese në qershor, por pati një rritje tjetër të masave të ashpra gjatë korrikut deri në shtator 2020.

Maqedonia e Veriut

Reagimi i qeverisë ndaj pandemisë COVID-19 ndoqi një model të ngjashëm në Maqedoninë e Veriut - ashtu si në vendet e tjera të rajonit (asnjë grafik nuk ishte i disponueshëm për këtë vend). Rasti i parë i COVID-19 u konfirmua në 26 shkurt. Më 13 mars, dy komuna, Dibra dhe Centar Zhupa, u vendosën në karantinë. Qeveria e Maqedonisë së Veriut shpalli gjendjen e jashtëzakonshme nga 18 marsi deri më 13 qershor. Qeveria nuk mund të merrte miratim nga parlamenti, sepse legjislatura ishte shpërndarë para pandemisë (Tsifakis, 2020, f. 198). Më 30 prill, qeveria njoftoi se viti shkollor do të zhvillohej on-line dhe do të përfundonte më 10 qershor. Masat emergjente sollën rënie të përhapjes së virusit në Maqedoninë e Veriut (shih Figurën 3). Më 12 maj, qeveria miratoi planin për heqjen graduale të kufizimeve; megjithatë, më 15 qershor, presidenti i vendit shpalli përsëri gjendjen e jashtëzakonshme (për herë të pestë), e cila zgjati 8 ditë. Më 15 korrik, u mbajtën zgjedhjet parlamentare.

Greqia




Figura 7. Trajektorja e Greqisë për pandeminë COVID-19

Burimi: Gjurmuesi i masave së qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit (OxCGRT). <https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk/>

Trajektorja e reagimit qeveritar krahasuar me vdekjet e përditshme për shkak të pandemisë COVID-19 në Greqi tregon përputhje të konsiderueshme midis reagimit qeveritar dhe kërcënimit nga COVID-19. Masat e para të izolimit reduktuan përhapjen e virusit në këtë vend. Ndërsa shkalla e kërcënimit gjatë muajve mars deri në maj u reduktua si pasojë e masave kufizuese, Greqia nuk shpalli gjendjen e jashtëzakonshme. Masat kufizuese u lehtësuan gjatë qershorit deri në gusht. Pas kësaj periudhe, gjatë shtatorit deri në tetor, shtimi i masave u bë në raport me rritjen e rasteve me COVID-19.

Me rritjen e rasteve dhe vdekjeve për shkak të pandemisë COVID-19, Greqia shpalli një izolim tjetër gjatë 7 - 30 nëntorit, duke ndaluar të gjitha tubimet. Në fund të shtatorit, ky vend ndaloi gjithashtu hyrjen për të gjithë qytetarët që nuk ishin nga vendet-anëtare të Bashkimit Evropian dhe ndryshoi kufizimet për vizitorët nga vende me infektime më të ulëta.²² Mbrojtësit e të drejtave të njeriut kanë kritikuar qeverinë greke se nuk ka vepruar në nivelin e duhur për të mbrojtur refugjatët që jetojnë në ambiente të mbipopulluara (Cosse, 2020).

²²Shih profilin e Greqisë në: <https://www.idea.int/gsod-indices/#/indices/countries-regions-profile>

Slovenia




Figura 8. Trajektorja e Sllovenisë për pandeminë COVID-19

Burimi: Gjurmuesi i masave të qeverive ndaj Coronavirusit të universitetit të Oksfordit (OxCGRT). <https://covidtracker.bsg.ox.ac.uk/>

Slovenia nuk e shpalli gjendjen e jashtëzakonshme edhe pse nëni 92 i Kushtetutës së saj lejon një gjë të tillë kur një rrezik i madh kërcënon ekzistencën e shtetit. Në vend të kësaj, qeveria sllovene mori masa të bazuara në legjislativ dhe zakonshëm, duke përfshirë nën 7 të Ligjit për Sëmundjet Infektive.²³ Më 4 mars, Sllovenia njoftoi rastin e parë të konfirmuar me COVID-19. Sllovenia ishte vendi i parë në BE që vendosi izolimin në rang kombëtar. Këto masa ulën ndjeshëm përhapjen e virusit (Figura 8). Fillimisht, gjatë periudhës 12 mars - 15 prill, qeveria miratoi një dekret mbi shpalljen e pandemisë COVID-19. Qeveria miratoi disa masa, të tilla si ndalimi ose kufizimi i lëvizjes së popullsisë në zonat e mbrojtura dhe ndalimi i grumbullimit të njerëzve në shkolla, kinema dhe mjedise të tjera publike. Në 30 mars, Sllovenia shtoi ndalimin e lëvizjes jashtë qendrave të përhershme ose të përkohshme të banimit; ky akt u pezullua nga Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, e cila urdhëroi qeverinë të rishikonte menjëherë arsyetimin e masave dhe më pas ta bënte këtë gjë të paktën një herë në shtatë ditë (European Parliament Briefing, 2020, 11). Dekreti mbi shpalljen e epidemisë

²³Shh: <http://www.pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO433#>

COVID-19 përfundoi në 14 maj kur masat u lehtësuan dhe lokalet (baret dhe restorantet) filluan punën në ambiente të hapura. Ekspertët rishikonin masat emergjente një herë në shtatë ditë dhe qeveria njoftonte vazhdimisht nëse masat do të vazhdonin të zbatoheshin në formën aktuale apo do të ndryshoheshin. Më pas njoftoheshin parlamenti dhe publiku. Kjo procedurë tregon një shkallë të lartë përgjegjësie dhe llogaridhënieje nga ana e qeverisë ndaj ekspertëve dhe publikut (Luksic, 2020, 36). Rastet me COVID-19 ishin të pakta nga qershori deri në mes të shtatorit, gjë që tregonte se masat reduktuan në mënyrë efektive shkallën e infeksionit dhe vdekjeve. Sidoqoftë, rastet filluan të rriteshin përsëri në fund të shtatorit. Në nëntor dhe dhjetor 2020, rastet shënuan pikun. Qeveria e Sllovenisë ndërmoi masa akoma më kufizuese për t'i bërë ballë rritjes së infektiveve dhe vdekjeve.

Referuar trendeve të përshkruara më sipër, është e rëndësishme të shqyrtojmë nëse publiku në këto vende të Ballkanit Perëndimor e kuptoi arsyetimin dhe ofroi mbështetje të përgjithshme për këto masa shtrënguese të qeverisë. Një sondazh për matjen e perceptimit publik në Ballkanin Perëndimor (përfshirë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë) i kryer në maj 2020 nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council - RCC) tregon se qytetarët e këtyre vendeve perceptuan kërcënimin e paraqitur nga pandemia dhe në këtë mënyrë më së shumti mbështetën masat qeveritare për të frenuar përhapjen e virusit (Talevska & Zoric, 2020). Sipas këtij sondazhi, më shumë se 70 për qind e të anketuarve në Ballkanin Perëndimor treguan frikën e tyre të konsiderueshme nga kërcënimi i pandemisë në ekonominë globale dhe kombëtare. Qytetarët në të gjithë rajonin ishin kryesisht në favor (83 për qind) të karantinës së detyrueshme për ata që mund të ishin infektuar. Në mënyrë të ngjashme, 79 për qind e të anketuarve mbështetën vendosjen e vetë-izolimit të detyrueshëm ose ndalimet e udhëtimit për në/nga ekonomitë më të prekura nga pandemia. Gjithashtu, 76 për qind e të anketuarve mbështetën masat paraprake që u ndërmoren për të ndihmuar në kontrollin e virusit, të tilla si distancimi social dhe mbajtja e maskave e dorezave. Kishte mbështetje të vazhdueshme në shumicën e vendeve për masa të tilla parandaluese: 85 për qind e të anketuarve në Shqipëri, 87 për qind në Maqedoninë e Veriut dhe 78 për qind në Serbi; të gjithë këta theksuan mbështetjen e tyre për masat e marra nga qeveritë përkatëse (Talevska & Zoric, 2020).

Sipas një studimi të parlamentit evropian (2020), 77 për qind e të anketuarve në Greqi dhe 54 për qind e të anketuarve në Slloveni ishin të kënaqur me masat që qeveritë përkatëse kishin marrë kundër pandemisë së koronavirusit. Këto të dhëna tregojnë se publiku në përgjithësi mbështeti masat që morën qeveritë për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe për të parandaluar vdekjen e qytetarëve të tyre gjatë pandemisë.

Perceptimi i publikut për cilësinë, besueshmërinë dhe disponueshmërinë e informacionit paraqet një aspekt tjetër të rëndësishëm të funksionimit të demokracisë gjatë një emergjence të shëndetit publik siç është pandemia COVID-19. Sipas "Barometrit Ballkanik: vlerësimi i ndikimit të Covid-19"

(“Balkan Barometer 2020: Covid-19 impact assessment”), i realizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (Talevska & Zoric, 2020), të anketuarit nga Ballkani Perëndimor deklaruan se profesionistët e shëndetit publik (si mjekët dhe infermierët) ofruan informacionin më të besueshëm mbi krizën; këta u pasuan nga zyrtarë të qeverive ose televizionet. Në rastin e Shqipërisë, besimi tek profesionistët u rrit gjatë kësaj periudhe, duke ndjekur trendin ekzistues të emergjencës së mëparshme – përkatësisht tërmeti i 26 nëntorit 2019 (WFD, 2020b). Kjo tregon besimin në rritje që qytetarët kanë për profesionistët e shëndetit publik gjatë këtyre krizave. Siç tregohet në Figurën 9, kishte më shumë gjasa që të anketuarit nga Shqipëria të besonin tek profesionistët e shëndetit dhe zyrtarët e qeverisë sesa tek televizionet dhe burime të tjera të informacionit në krahasim me të anketuarit nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Sipas të dhënave të sondazhit nga parlamenti evropian (2020), shkencëtarët rezultuan profesionistët më të besuar për marrjen e informacionit në Greqi (58%) dhe Slloveni (37%).




Figura 9. Reagimet krahasuese të pyetjes: Në cilin prej burimeve të mëposhtme të informacionit keni më shumë besim në lidhje me saktësinë e informacionit që jepet për koronavirusin?

(Shënim: Të gjithë të anketuarit, N = 3078; maksimumi 3 përgjigje; pjesa e përqindjes së totalit. Ky studim nuk përfshin Greqinë dhe Slloveninë. Burimi: Talevska & Zoric, 2020).

Nga një perspektivë ekonomike, masat kufizuese të miratuara gjatë pandemisë shkaktuan problematika të mëdha në nivel rajonal dhe global. Sipas raportit të “Barometrit Ballkanik” (të realizuar nga RCC), vetëm 32 për

qind e të anketuarve ishin të kënaqur me mënyrën sipas së cilës qeveria e tyre veprroi në mënyrë që njerëzit të mos humbnin vendet e tyre të punës si rezultat i pandemisë (Talevska & Zoric, 2020). Individët e renditën ndryshe kënaqësinë e tyre për reagimin e qeverisë: 31 për qind e të anketuarve në Shqipëri, 30 për qind e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut dhe 61 për qind e të anketuarve në Serbi - duke demonstruar kënaqësinë e tyre për reagimin të qeverisë së tyre ndaj rënies ekonomike (Talevska & Zoric, 2020). Të anketuarit shqiptarë treguan gjithashtu se i besonin informacionit të marrë nga qeveria e tyre më shumë sesa të anketuarit në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Së bashku, këta tregues të ndryshëm paraqesin një panoramë komplekse të mënyrës se si qytetarët e perceptojnë performancën e qeverive për të frenuar përhapjen e pandemisë. Ndërsa duket se publiku favorizon masat kufizuese për të ngadalësuar përhapjen e virusit dhe për të mbrojtur jetën, qytetarët shqetësohen gjithashtu për rënien ekonomike që shkaktojnë masa të tilla kufizuese.

Si përfundim, ishte e qartë se kufizimet për shkak të pandemisë COVID-19 prishën ekuilibrat e jetës normale. Megjithatë, shumë qytetarë i konsideruan këto kufizime si të nevojshme. Kur u pyetën për kufizimet e vendosura për lirinë e tyre gjatë pandemisë, një mesatare prej vetëm 26 për qind e të anketuarve shfaqën pakënaqësi për vendosjen e tyre. Konkretisht, 28 për qind e të anketuarve në Shqipëri, 27 për qind e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut dhe 20 për qind e të anketuarve në Serbi shprehën mospajtim me vendosjen e kufizimeve të tilla (Talevska & Zoric, 2020). Kjo tregon mbështetje të mëtijshme për masat e sigurisë kombëtare. Të dhënat nga sondazhet publike sugjerojnë se publiku mbështeti masat qeveritare që parandaluan përhapjen e COVID-19. Për më tepër, kishte më shumë gjasa që publiku t'u besonte informacioneve të marra nga shkencëtarë, profesionistë dhe ekspertë të shëndetit.

8. Reagimi ndaj pandemisë COVID-19 në kontekstin e të drejtave të njeriut

Në kuadër të vlerësimit të reagimit të Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19 nga perspektiva e të drejtave të njeriut, katër parimet e ligjshmërisë, kuadrit të kufizuar kohor për masat emergjente, domosdoshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimin ekzekutiv shërbejnë si kornizë e dobishme për të trajtuar zbatimin - nga ana e qeverisë - e normave, standardeve dhe praktikave themelore të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Gjatë muajve të parë të pandemisë, si e përmbushi qeveria shqiptare parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit sundimi i ligjit duhet të mbizotërojë edhe gjatë një gjendjeje të jashtëzakonshme? Në kontekstin e pandemisë, rreziku për shëndetin publik u pa si kërcënim për sigurinë kombëtare. Në këtë mënyrë u justifikua kufizimi i përkohshëm i disa të drejtave të njeriut në mënyrë proporcionale dhe ligjore. Baza ligjore për administrimin e situatave emergjente në Shqipëri sanksionohet në Kushtetutën e Shqipërisë (1998), ligjin "Për emergjencat civile" (2019), ligjin "Për parandalimin dhe luftën kundër infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" (2016), dhe ligjin për "Shëndetin Publik" (2009). Kushtetuta e Shqipërisë (1998) rregullon praktikatat vendimmarrëse të gjendjes së jashtëzakonshme. Neni 170 i Kushtetutës përcakton se "aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit". Gjatë gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet asnjë prej këtyre akteve: Kushtetuta, ligjet e zgjedhjeve për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet për masat e jashtëzakonshme (ISP 2020, 18). Neni 74 i Kushtetutës lejon thirrjen e një sesioni të jashtëzakonshëm të parlamentit, në mënyrë që të rishikohet miratimi i masave të lidhura me emergjencat, të kufizuara në kohë dhe fushëveprim, siç parashikohet në nenin 174. Për më tepër, sipas nenit 84, në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare (WFD dhe Krasniqi, 2020).

Në 31 mars, qeveria shqiptare njoftoi Këshillin e Evropës se do të vononte zbatimin e ligjeve për të drejtat e njeriut (shmagje nga detyrimet) sipas neneve 8 dhe 11 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Të drejtat e cënuara nga përjashtimi ishin neni 8: E drejta për privatësi; Neni 11: Liria e Tubimit dhe Organizmit; Neni 1, Protokollit 1: Mbrojtja e Pronës; Protokollit 1, Neni 2: E drejta për Arsimit; dhe Neni 2, Protokollit 4: Liria e Lëvizjes.²⁴ Qeveria u tërhoq nga kjo iniciativë, duke u zotuar se do të zbatonte plotësisht detyrimet që rrjedhin nga konventa, më 24 qershor

²⁴Notification - JJ9020C Tr./005-231. 1 prill 2020. Deklarata në lidhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (ETS No. 5). <https://rm.coe.int/16809e0fe5> Maqedonia e Veriut paraqiti përjashtimin për të njëjtën listë të të drejtave, ndërsa Serbia paraqiti përjashtimin e saj pa një listë të të drejtave. shih: <https://rm.coe.int/16809e1288>.

2020.²⁵ Sipas këtyre dispozitave ligjore, qeveria shqiptare përmbushi në një shkallë të konsiderueshme kërkesat e parimit të parë të ligjshmërisë të Këshillit të Evropës (2020).

Shqipëria plotësoi gjithashtu parimin e dytë të kohëzgjatjes së kufizuar të emergjencës dhe masat e saj. Ligjet e emergjencave u zbatuan për tre muaj në Shqipëri. Gjatë periudhës mars - qershor, për sa i përket masave të marra nga qeveria, mbizotëroi tendenca e minimizimit të përhapjes së COVID-19 në kurriz të efekteve ekonomike në kategori të ndryshme shoqërore dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Izolimi u shoqërua me paketa ndihme nga qeveria për kategori të ndryshme shoqërore dhe bizneset.

Qeveria e Shqipërisë plotësoi vetëm pjesërisht parimin e tretë të domosdoshmërisë në përmbushjen e qëllimeve të saj për ndryshimin minimal të mundshëm të rregullave dhe procedurave normale demokratike. Në disa raste, reagimet e tepruara u kritikuan nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Për shembull, qeveria shqiptare miratoi dënime jo-proporcionale si forma ndëshkuese për shkeljen e rregullave të karantinës (u propozua dënimi me burg deri në 15 vjet). Për më tepër, për të zbatuar ndalim-qarkullimin, qeveria shqiptare mobilizoi ushtrinë dhe policinë²⁶ për të patrulluar rrugët.²⁷

Gjatë muajit të parë të izolimit, policia vuri 7107 gjoba për këmbësorët dhe 1941 gjoba për shoferët.²⁸ Qeveria gjobiti 266 biznese për shkeljen e rregullave të karantinës. Më 23 prill, qeveria vendosi të ashpërsonte ndëshkimet për njerëzit që shkelnin rregullat e karantinës duke bërë ndryshime në kodin penal. Kodi Penal Shqiptar²⁹ u ndryshua, dhe u përfshinë sanksione për shkeljet e masave të vendosura nga autoritetet shtetërore gjatë një epidemie, gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, si dhe gjatë përhapjes vullnetare së sëmundjeve infektive. Mosrespektimi i karantinës ose izolimit të detyrueshëm u konsiderua i dënueshëm me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Sipas ligjit, në rastet kur mosrespektimi i rregullave shkaktonte përhapje të sëmundjes infektive me rrezik të lartë për shëndetin e njeriut, do të kishte dënime me burgim deri në pesë vjet. Kur një përhapje e tillë krijonte pasoja të rënda për shëndetin ose për jetën e njeriut, do të kishte dënime me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet kur shkelja shkaktonte vdekjen e një ose më shumë personave.³⁰ Civil Rights Defenders, një organizatë ndërkombëtare, veprimtaria e së cilës fokusohet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, u pozicionua në krah të 29 organizatave shqiptare të shoqërisë civile, duke iu kundërvënë këtij propozimi

²⁵Shih:<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations>.

²⁶Shih:<https://www.usnews.com/news/world/articles/2020-03-21/albania-deploys-troops-to-enforce-40-hour-coronavirus-curfew>

²⁷Në dhjetor 2020, të shtënat fatale ndaj një të riu 25-vjeçar të paarmatosur nga një oficer policie shkaktuan protesta dhe më pas në dorëheqjen e Ministrit të Brendshëm të Shqipërisë. Shiko:<https://balkaninsight.com/2020/12/11/albania-police-clashes-with-protesters-as-minister-of-interiors-resigns/>

²⁸Shih:Euronews Albania. 2020. Falen Gjobat e COVID-19. Rama: S'do te ekzekutohen. <https://euronews.al/al/aktualitet/2020/04/17/falen-gjobat-e-covid-19-rama-s-do-te-ekzekutohen>

²⁹Për disa shtesa dhe amendime të Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

³⁰Shih:Kodi Penal i Shqipërisë. Nenet 242/1 dhe 89 /b.

të qeverisë shqiptare për të dënuar njerëz deri në 15 vjet burg për shkelje të izolimit.³¹

Pas miratimit të ndryshimeve në Kodin Penal Shqiptar, disa muaj më vonë qeveria miratoi një akt për faljen e ndëshkimeve financiare dhe administrative të tilla si gjobat për 7107 këmbësorët dhe 1941 shoferët, si dhe për bizneset e gjobitura gjatë muajit të parë të izolimit. Qeveria pretendonte se masat e ndërmarra prej saj ishin të suksesshme në luftën kundër përhapjes së virusit; megjithatë, anulimi i gjobave të vëna gjatë muajit të parë të izolimit tregon një tërheqje të qeverisë nga zbatimi i sanksioneve më të ashpra. Sipas fokus-grupeve dhe intervistave të kryera në këtë studim, pezullimi i gjobave të vëna nga qeveria gjatë periudhës së karantinës krijoi bindje të fortë tek një pjesë e qytetarëve se e njëjta gjë do të ndodhte me gjobat e vendosura gjatë periudhës vijuese shtator - dhjetor; megjithatë, nuk ndodhi kështu. Masat e marra gjatë muajve shtator-dhjetor 2020 përfshinin vënien e detyrueshme të maskës në vende publike, ndalimin e protestave dhe protokollat e sigurisë për bizneset. Si përmbledhje, në dhjetor 2020, Shqipëria mbledhi 2,781,920,000,000 mijë lekë të vjetra nga gjobat e vendosura për mosrespektim të këtyre masave të sigurisë.³²

Qeveria shqiptare u kritikua gjithashtu për kufizimin e lirisë së medias për shkak të ligjit anti-shpifje që u miratua para pandemisë. Në dhjetor 2019, parlamenti shqiptar miratoi ligjin anti-shpifje për të rregulluar mediat online, mbi të cilat do të ushtronte kontroll Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Qeveria u autorizua të bllokonte media të tilla online në rast dezinformimi. Shtrirja e fushëveprimit të rregullores për përdoruesit e internetit do të dëmtonte pluralizmin e mediave dhe mund të shkaktojte vetë-censurim nga media online dhe blogerët individualë. Në qershor 2020, Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës ofroi një opinion për këtë çështje: ky ligj nuk duhej të miratohej për shkak të problematikave mbi vetë-censurimin dhe kufizimin e lirisë së shprehjes në media.³³

Në Shqipëri, gjatë izolimit, Kryeministri u përplas me mediat gjatë një komunikimi të tij të drejtpërdrejtë me njerëzit përmes kanaleve të tij personale të medias (ERTV) dhe platformave të mediave sociale (më e rëndësishmja, Facebook). Kryeministri Rama u kritikua kur deklaroi: "Lani duart, mos lëvizni nga shtëpia për kënaqësi, hapni dritaret sa më shumë që të keni mundësi dhe mbrohuni nga media". Ky ishte një mesazh zanor i transmetuar për të gjithë abonentët celularë të rrjetit të Vodafone në Shqipëri gjatë javës së parë të masave të jashtëzakonshme (Erebara, 2020). Rama iu referua gjithashtu

³¹Shih: <https://crd.org/2020/04/16/albanias-government-unconstitutionally-pushes-draconian-sentences-in-fight-against-covid-19/>

³²Shih. <https://www.asp.gov.al/>. Nga të dhënat e publikuara nga policia, nga 15 tetori deri më 28 dhjetor, për shkak të mosmbajtjes së maskës në vendet publike, u gjobitën në total 40,854 shtetas, me 30 mijë lekë të vjetra, në total 1,225,620,000. Për moszbatim të protokollit në kushte pandemie, u gjobitën 130 biznese me 10 milion lekë të vjetra, në total 1,300,000,000 (një miliard e treqind milionë) lekë të vjetra. Për shkelje të ndalim-qarkullimit, u gjobitën 233 shtetas me 100 mijë lekë të vjetra, në total u mbledhën 23,300,000 (njëzet e tre milion e treqind) mijë lekë të vjetra. Për organizimin e protestave në kohë pandemie, u gjobitën 2 shtetas me 50 milion lekë të vjetra, në total 100,000,000 (njëqind milionë) lekë të vjetra. Në total, Shqipëria ka mbledhur 2,781,920,000 mijë lekë të vjetra nga gjobat e vendosura nga 15 tetori deri më sot, 28 dhjetor.

³³Shih: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)013-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)013-e)

medias si "kazan", pasi organizatat e medias kritikuan qeverinë për monopolizimin e informacionit (WFD, 2020b, 77). Media e shkruar pësoi humbje të mëdha nga kufizimet e COVID-19, pasi shtypshkronjat nuk punuan gjatë marsit dhe prillit 2020 dhe gazetat u botuan vetëm në internet. Për shkak të rregullave të reja për të mos lejuar më shumë se dy persona në një dhomë në të njëjtën kohë, shfaqjet televizive u anuluan gjithashtu. Gazetarët e kishin të vështirë të punonin në terren, pasi nuk kishin në dispozicion procedura të përshtatshme për të mbrojtur veten dhe njerëzit që intervistonin. Gjatë kësaj periudhe, kryeministri përdori gjithashtu metafora që lidhen me konceptin e "luftës" si "pagat e luftës" (ndihma financiare e shtetit), "spitalet e luftës" (objektet mjekësore që përballen me COVID-19), "rezistenca në kohë lufte" (karantina), "lajme të rreme në kohë lufte" (kritikë ndaj mediave)" (WFD dhe Krasniqi, 2020, 13). Kjo sjellje e qeverisë dhe Kryeministrit në veçanti gjatë kësaj periudhe konfirmohet nga opinionet e shprehura në intervista dhe fokus-grupe të zhvilluara me përfaqësues të mediave kryesore, shoqërisë civile dhe akademikëve në Shqipëri. Të anketuarit e fokus grupeve deklaruan se:

Në fillim të pandemisë, kishim përshtypjen se qeveria dhe institucionet qeveritare ishin të hapura për shkëmbimin e çdo informacioni në lidhje me menaxhimin e situatës emergjente. Sidoqoftë, me kalimin e ditëve, informacioni filloi të pakësohej. Me fjalë të tjera, ne u përballëm me fenomenin e hinkës që u hap fillimisht nga qeveria dhe më pas, me përkeqësimin e situatës, filloi të mbyllej. Sa është numri i rasteve të infektuara? Si funksionon zinxhiri i kujdesit shëndetësor? Si funksionon gjurmimi i infeksionit? Sa testimë bëhen? etj.³⁴ Në fillim të pandemisë, qeveria ishte më e gatshme të bashkëpunonte me median dhe të siguronte informacion, ndërsa, pasi situata u përkeqësua, kjo frymë bashkëpunimi media-qeveri filloi të zbehej.³⁵

Sipas pjesëmarrësve të fokus-grupeve, problemi i kufizimit të aktivitetit të mediave në javët e para të pandemisë nuk lidhet vetëm me rolin e Kryeministrit për të censuruar median. Edhe vetë mediat u gjendën të papërgatitur për të përballuar një situatë të tillë. Periudha emergjente e pandemisë shërbeu si leksion për mediat, të cilat duhej të mësonin se si të informonin publikun në një situatë të jashtëzakonshme.

Pjesëmarrësit e fokus-grupeve nga sektori i shëndetësisë, shoqërisë civile dhe mediave theksuan gjithashtu se vendimmarrja në Shqipëri dominohej nga Kryeministri. Ata vunë në dyshim pavarësinë e ekspertëve që punonin në qeveri. Pjesëmarrësit shqiptarë të fokus-grupeve mbështetën gjithashtu përfshirjen e shoqërisë civile në konsultimet mbi hartimin e masave emergjente.

Gjatë muajve tetor-dhjetor 2020, qeveria ishte më e hapur dhe transparente me mediat. Në të njëjtën kohë, mediat u treguan shumë më aktive në raportimin nga terreni. Në përgjithësi, ekspertët luajtën rol të rëndësishëm në raportimin dhe komentimin e situatës. Një nga gazetarët e fokus-grupit

³⁴Gazetar i televizionit A2 CNN – pjesëmarrës në fokus-grup.

³⁵Gazetar i televizionit shqiptar TVSH – pjesëmarrës në fokus-grup.

deklaroi: "marrëdhënia media-qeveri për periudhën shtator-dhjetor u përmbys – në krahasim me periudhën mars-qershor".³⁶

Në mënyrë të ngjashme, ekspertët spikatën edhe më shumë në komunikimin për pandeminë pas mbarimit të zbatimit të masave të jashtëzakonshme. Në periudhën shtator - dhjetor 2020, prania e Kryeministrit dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në media dhe rrjetet sociale u zvogëluar shumë në raport me praninë e ekspertëve të shëndetit publik. Komiteti Teknik i Ekspertëve u bë burimi kryesor i informacionit mbi situatën e pandemisë; prania e anëtarëve të këtij Komiteti në media, konferenca për shtyp dhe debate publike ishte më e dukshme në këtë periudhë. Komiteti Teknik i Ekspertëve bënte publike rekomandimet përpara çdo vendimi të marrë nga ministritë e linjës. Kjo pikë mbështetet gjithashtu nga intervistat e bëra me studiues dhe ekspertë të fushës, si dhe nga mendimet e dhëna nga gazetarët në fokus-grup.

Parimi i katërt - i rëndësishëm në përcaktimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të reagimit të Shqipërisë ndaj pandemisë - ka të bëjë me shpërndarjen e kompetencave dhe kontrollit mbi veprimet ekzekutive. Në Shqipëri, një akt normativ si "Gjendja e Fatkeqësisë Natyrore" që u iniciua më 24 mars, duhej të ishte miratuar brenda 5 ditëve nga parlamenti. Sidoqoftë, parlamenti votoi për këtë vendim më 16 prill, duke u përqendruar në kohëzgjatjen e zbatimit të masave (ISP, 2020, 1) në vend që të vendosej për domosdoshmërinë e këtyre masave ose mënyrën e mbikëqyrjes për zbatimin e tyre; situata emergjente ishte justifikimi i kësaj vonese.³⁷ Për shkak të procesit të verifikimit, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë nuk ishte funksionale gjatë periudhës së emergjencës dhe për këtë arsye nuk mund të kontrollonte veprimet ekzekutive.

Për periudhën mars-maj 2020, parlamenti shqiptar nuk zhvilloi asnjë seancë pyetje-përgjigje përsituatën e pandemisë COVID-19. Për më tepër, parlamenti nuk krijoi një komision për të hetuar për epideminë dhe nuk ngriti asnjë strukturë monitorimi për masat e marra nga ekzekutivi. E njëjta situatë u përsërit gjatë periudhave shtator-tetor dhe nëntor-dhjetor, pavarësisht nga fakti se jeta parlamentare zhvillohej normalisht. Çdo gjë shkonte sipas rutinës - përveç mbajtjes së detyrueshme të maskës gjatë seancave plenare (ISP, 2020).

Sipas monitorimit të kryer nga ISP (2020, 27), për periudhën janar - korrik 2020, parlamenti shqiptar miratoi një numër rekord ligjesh; një total prej 115 ligjesh u miratuan, krahasuar me 55 dhe 57 ligje në të njëjtat periudha në vitet 2018 dhe 2019. Gjatë periudhës 15 mars - 23 qershor, Këshilli i Ministrave miratoi 30 akte normative me fuqinë e ligjit. Kushtetuta e Shqipërisë, neni 101, njehtë drejtën e Këshillit të Ministrave, në rast nevojë dhe në kushte urgjence, për të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, si masa të përkohshme (WFD dhe Krasniqi, 2020, 5). Numri i madh i ligjeve të miratuara gjatë fazës

³⁶Gazetar i televizionit Euronews – pjesëmarrës në fokus-grup.

³⁷Duhet të theksohet se një pjesë e territorit shqiptar ishte tashmë në Gjendje të Fatkeqësisë Natyrore për shkak të tërmetit shkatërrimtar të 26 Nëntorit.

së parë të pandemisë parashtron shqetësime në lidhje me kohën e disponueshme për plotësimin e kërkesave të duhura ligjore dhe konsultimin publik. Konsultimi i nismave ligjore me grupet e interesit është një procedurë standarde, kërkesë ligjore, praktikë demokratike dhe kriter i nevojshëm për funksionimin e shtetit të së drejtës. Mungesa e konsultimeve dhe mospërfshirja e grupeve të interesit evidentohen në reagimin e disa shoqatave ndaj ligjeve specifike si dhe në fokus-grupin me përfaqësuesit e shoqërisë civile.³⁸ Disa nga iniciativat, të tilla si amnistia fiskale dhe ndryshimet në legjislacionin për policinë e shtetit, u kritikuan nga organizatat ndërkombëtare për mungesën e konsultimit dhe përmbajtjen problematike. Nën këtë presion ndërkombëtar, parlamenti shtyu në kohë miratimin e këtyre iniciativave ose u tërhoq plotësisht nga miratimi i tyre (ISP, 2020, 27).³⁹ Meqenëse parlamenti dhe gjyqësori nuk monitoruan në nivelin e duhur zbatimin e masave emergjente, parimi i katër të përmbush vetëm pjesërisht.

Duke krahasuar mënyrat se si qeveritë reagojnë ndaj pandemisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ngrihen disa çështje. Para së gjithash, vendet që shpallën gjendjen e jashtëzakonshme ose një status ekuivalent ishin demokracitë hibride të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Veçanërisht në këto vende, kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19 nxori në pah dobësitë ekzistuese në institucionet demokratike dhe sundimin e ligjit.

Së pari, parlamentet në këto vende e patën të vështirë të mbikqyrnin rregullat ekzekutive dhe zbatimin e tyre. Në Serbi, qeveria anashkaloi parlamentin kur deklaroi Gjendjen e Jashtëzakonshme pa bazë ligjore (Cuckić & Ivković, 2020). Pandemia rriti polarizimin në Serbi, ndërsa disa parti politike bojkotuan procedurat parlamentare, për shkak të shkeljes së perceptuar të procedurave nga partia në pushtet. Zgjedhjet në Serbi të planifikuara për në datën 26 prill u shtynë për në 21 qershor. Misioni për Vlerësimin e Zgjedhjeve, pjesë e OSBE-së, vuri në dukje disa problematika; pavarësisht zgjedhjeve të rregullta, qeveria kontrollonte mediat dhe u zhvillua debat i kufizuar mbi politikën në Serbi.⁴⁰ Kështu, Serbia nuk e përmbushi plotësisht parimin e ligjshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimet ekzekutive, plotësoi pjesërisht parimin e domosdoshmërisë dhe përmbushi parimin e kuadrit të caktuar kohor për masat emergjente.

Në Maqedoninë e Veriut, kur u përhap pandemia, parlamenti që shpërndarë dhe vendi po përgatitej për zgjedhjet parlamentare. Presidenti Pendarovski shpallë gjendjen e jashtëzakonshme, pasi Maqedonia e Veriut nuk mund të merrte miratimin nga legjislativi. Qeveria kujdestare e përkohshme drejtoi Maqedoninë e Veriut përmes dekreteve, ndërsa Presidenti zgjati gjendjen e jashtëzakonshme katër herë pa miratimin e parlamentit. Meqenëse vetëm një

³⁸<https://ahc.org.al/deklarate-e-perbashket-per-median/>

³⁹Për periudhën tetor - dhjetor 2020, parlamenti miratoi 50 ligje dhe vetëm një akt normativ. Numri shumë i ulët i akteve normative krahasuar me periudhën mars - qershor ka të bëjë me heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Shih <https://www.parlament.al/LibrariaAkteve>. Në këtë periudhë, mungesa e përfshirjes së shoqërisë civile ishte problematike - siç dëshmohej në rastin e reformës zgjedhore bazuar në raportin e Komisionit të Venecias. Shih <https://www.osce.org/files/f/documents/7/2/473655.pdf>.

⁴⁰OSCE 2020. ODIHR Special Election Assessment Mission. Republic of Serbia—Parliamentary Elections. <https://www.osce.org/files/f/documents/8/e/455155.pdf>

e treta e dekreteve të qeverisë kujdestare kishin të bënin me pandeminë, kritikët deklaruan se qeveria tejkaloi mandatin e saj (Markovikj, 2020).

Maqedonia e Veriut shtyu zgjedhjet e planifikuara në datën 12 prill për në 15 korrik. Partitë politike ranë dakord që të mos organizonin tubime publike para zgjedhjeve dhe të zhvillonin fushatën në on-line dhe përmes mediave tradicionale. Maqedonia e Veriut hasi pengesa gjatë pandemisë për shkak të mungesës së një parlamenti funksional. Maqedonia e Veriut, ashtu si Serbia, nuk përbushi parimin e ligjshmërisë dhe parimin e shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimet ekzekutive, ndërsa përbushi parimet e domosdoshmërisë dhe kuadrin të caktuar kohor për masat emergjente.

Në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni të Veriut, shteti u përqendrua në zbatimin e distancës fizike përmes masave shtypëse, duke përfshirë gjopa të larta gjatë ditëve të para të krizës së shkaktuar nga COVID-19. Si në Shqipëri ashtu edhe në Serbi, qeveria mobilizoi ushtrinë⁴¹ për të patrulluar rrugët në funksion të zbatimit të ndalim-qarkullimit; zbatimi i masave të tilla shtypëse nënvizon frikën e qeverisë dhe publikut ndaj përhapjes së COVID-19, si dhe pranimin e dobësive të sistemit të kujdesit shëndetësor (Beiber et al., 2020, 7).

Qeveritë u përpoqën të kontrollonin mediat më shumë në Shqipëri, Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe, pas ndryshimit të qeverisë, edhe në Slloveni. Shoqëria civile dhe media ishin më të hapura në Greqi. Në Serbi, në kuadër të këtyre masave, qeveria përfshiu një praktikë ndëshkuese për gazetarët: nëse përdornin "burime jozyrtare" të informacionit, ata do të ndiqeshin penalisht.⁴² Për më tepër, Misioni për Vlerësimin e Zgjedhjeve, pjesë e OSBE-së, vuri në dukje disa problematika; pavarësisht zgjedhjeve të rregullta, qeveria kontrollonte mediat dhe u zhvillua debat i kufizuar mbi politikën.⁴³

Në Maqedoninë e Veriut, liria e medias nuk u mohua gjatë masave emergjente, pasi qeveria nuk arrestoi ose nuk kufizoi aktivitetet raportuese të gazetarëve. Qeveria zhvilloi konferenca shtypi të përditshme me mediat (Ministri i Shëndetësisë mernte pjesë më shpesh) dhe gazetarët patën mundësinë të bënin pyetje virtualisht përmes platformës Skype (Markovikj, 2020, 26).

Në Slloveni, qeveria e re, e udhëhequr nga ekstremisti i krahut të djathtë Janez Jansa, kufizoi aksesin në media duke pezulluar njoftimet për shtyp, si dhe duke kërcënuar gazetarët e mediave kryesore. Një media e lidhur me Partinë Demokratike Sllovene, kryetar i së cilës është kryeministri Jansa, kërcënoi një gazetar investigativ që punonte për organizatën Reporterët pa Kufij.⁴⁴ Kështu, ndërsa Sllovenia përbushi parimet e ligjshmërisë, kuadrin të caktuar kohor për masat emergjente dhe shpërndarjen e pushtetit përmes kontrolleve mbi

⁴¹Shih: <https://www.usnews.com/news/world/articles/2020-03-21/albania-deploys-troops-to-enforce-40-hour-coronavirus-curfew>

⁴²Shih: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Serbia.pdf>

⁴³Shih: OSCE 2020. ODIHR Special Election Assessment Mission. Republic of Serbia—Parliamentary Elections. <https://www.osce.org/files/f/documents/8/e/455155.pdf>

⁴⁴Shih: Anja Vladislavjevic. 2020. It'll be bloody: Under Jansa Troubled Times for Slovenian Media. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2020/04/28/itll-be-bloody-under-jansa-troubled-times-for-slovenian-media/>

veprimet ekzekutive, ajo plotësoi vetëm pjesërisht parimin e domosdoshmërisë.

Qeveritë e Shqipërisë dhe Serbisë përdorën gjithashtu kufizimet e imponuara nga situata emergjente për të kufizuar hapësirën e aktivizimit të shoqërisë civile. Shqipëria ndaloi protestat dhe tubimet masive si pjesë e masave të jashtëzakonshme për të parandaluar infeksionet me COVID-19.⁴⁵ Sipas monitorimit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, gjatë periudhës mars - korrik 2020, policia raportoi zhvillimin e 27 protestave ose demonstratave në Shqipëri dhe paraqiti 21 çështje në prokurori për akuzat e "prishjes së rendit publik" dhe "organizimit dhe pjesëmarrjes në tubime të paligjshme"; për më tepër, policia bëri ndalime të organizatorëve të protestave në katër raste dhe hodhi poshtë dy kërkesa për tubime publike gjatë kësaj periudhe.⁴⁶ Qeveria shqiptare botoi gjithashtu një vendim të diskutueshëm ligjor për prishjen e Teatrit Kombëtar në Tiranë dhe përdori forcën për të larguar nga Teatri protestuesit e pranishëm aty në orët e para të mëngjesit të datës 17 maj (Ruttershoff, 2020).

Në Serbi, aktivistët protestuan kundër qeverisë serbe për masat të ashpra të ndalim-qarkullimit, duke goditur zhurmshëm tenxhere e tiganë ndërsa qëndronin në ballkonet e shtëpive të tyre. Mbështetës të qeverisë u përgjigjën me kundër-protesta: ata ndezën pishtarë në çatitë e ndërtesave, gjë që përbënte shkelje të ndalim-qarkullimit se ishin jashtë shtëpive të tyre. Qeveria nuk ndërhyri, duke sinjalizuar aplikimin e një standardi të dyfishtë për mbështetësit e saj (Dragojlo & Stojanovic, 2020). Në Maqedoninë e Veriut, një incident i spikatur i protestave ndodhi në Shkup, kur, pas vendosjes së ndalim-qarkullimit, 150 njerëz protestuan si reagimi i arrestimit të tre individëve që kishin shkelur ligjin që kufizonte lëvizjen e qytetarëve (Markovikj, 2020, 25).

Qeveria greke miratoi gjithashtu legjislacionin për të kufizuar ose ndaluar protestat publike në zonat me përhapje të lartë të virusit COVID-19. Në Greqi, protesta u zhvilluan në disa burgje; kërkesat e të burgosurve kishin të bënin me mbipopullimin në burgje dhe mbrojtje më të mirë nga virusi (Këshilli i Evropës, 2020b). Për më tepër, 10,000 njerëz demonstruan në Athinë për të kundërshtuar legjislacionin që kufizonte ose ndalonte protestat publike edhe pse vlerësohej se ato kërcënonin sigurinë publike. Pasi një grup protestuesish hodhën bomba molotov në drejtim të policisë, kjo e fundit u përgjigj me gaz lotsjellës.⁴⁷

Në Slloveni, qeveria nuk e kufizoi hapësirën për aktivizim të shoqërisë civile gjatë pandemisë. Për shembull, kur 24 shoqata të udhëhequra nga Nisma Anarkiste e Lubjanës (Anarchist Initiative of Ljubljana) organizuan një protestë jo të dhunshme, policia i shoqëroi aktivistët në mënyrë paqësore. Në mënyrë

⁴⁵Neni 7 "Masa të veçanta" të Ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive, germa dhe pika 61 të VKM nr 234 datë 24/03/2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore".

⁴⁶<https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2020/09/1683.pdf>

⁴⁷<https://www.dw.com/en/greece-protests/a-54119094>

të ngjashme, një mijë çiklistë morën pjesë në një demonstrim për mbrojtjen e mjedisit në maj 2020 pa shkaktuar ndonjë incident (Luksic, 2020, 38).

Në përgjithësi, roli i ekspertizës dhe llogaridhënies politike ishte më i dukshëm në demokracitë e konsoliduara gjatë masave të jashtëzakonshme. Për shembull, në Slloveni dhe Greqi, qeveria ndoqi analizën e ekspertëve në lidhje me marrjen dhe zbatimin e masave që në fillim të përhapjes së pandemisë. Në Slloveni, shteti u mbështet tek rekomandimi i ekspertëve të shëndetit publik për të krijuar një qendër telefonatash (call center), prej nga ofrohej informacion në kohë reale mbi pandeminë COVID-19 dhe masat parandaluese përkatëse. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Slloveni shërbeu si qendër informuese për epideminë, nga ku mund të shkarkoheshin nga publiku materiale të ndryshme si dokumente në formatin PDF në katër gjuhë: sllovenisht, anglisht dhe dy gjuhë të pakicave - italisht dhe hungarisht. Qeveria prezantoi gjithashtu aplikacionin #OstaniZdrav (#Kujdesu për shëndetin), të cilin publiku mund ta instalonte në telefonat inteligjentë. Ky aplikacion ndihmoi në informimin dhe zbatimin e masave parandaluese, të tilla si respektimi i distancës, larja e rregullt e duarve dhe mbajtja e maskave mbrojtëse.⁴⁸ Për më tepër, në Slloveni, pas rekomandimit të Gjykatës Kushtetuese, ekspertët rishikonin masat emergjente një herë në shtatë ditë dhe qeveria vendoste nëse masat do të vazhdonin të zbatoheshin ose do të ndryshoheshin. Më pas qeveria njoftonte parlamentin dhe publikun (Luksic, 2020, 36). Këto procedura tregojnë një shkallë të lartë të llogaridhënies së qeverinë ndaj ekspertëve dhe publikut.

Në të kundërt, në regjimet hibride të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, roli i ekspertëve ndryshonte nga një vend në tjetrin gjatë masave emergjente. Në Maqedoninë e Veriut, ekspertiza mjekësore u përdor për të marrë vendime. Me një qeveri teknokrate të përkohshme në pushtet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Maqedonia e Veriut u mbështet shumë tek ekspertët mjekësorë për të vendosur për masat dhe për të komunikuar shpesh me publikun përmes konferencave për shtyp (Markovikj, 2020). Ndërkohë, në Serbi, partia në pushtet dhe zyrtarët e qeverisë mbizotëruan hapësirën mediatike, pavarësisht konferencave të rregullta për shtyp me ekipin e ekspertëve mjekësorë të shtabit të krizave (Tepavac & Branković, 2020a). Në Shqipëri, menaxhimi i krizës supozohej të drejtohej nga Ministria e Shëndetësisë dhe Komiteti ad-hoc i Ekspertëve. Megjithatë, roli i ekspertëve të shëndetit publik ishte i paqartë gjatë zbatimit të masave emergjente⁴⁹, por u bë më i qartë pas përfundimit të masave të izolimit.

Në reagimin e saj të përgjithshëm ndaj pandemisë, qeveria greke plotësoi katër parimet e ligjshmërisë, kuadrin të kufizuar kohor për masat emergjente, domosdoshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimet ekzekutive. Qeveria greke u mbështet së tepërmi tek ekspertët shkencorë, të cilët mbikëqyrnin ecurinë e pandemisë COVID-19 dhe ofronin informime të përditshme. Më 23 shkurt, Ministria greke e Shëndetësisë krijoi

⁴⁸<https://www.coe.int/en/web/good-governance/cddg-and-covid#%2264787140%22;191>

⁴⁹Friedrich Ebert Stiftung. (2020a). and., *Democracy and the state of emergency: Political battles emerging out of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 2, pp. 4-7.

një Komitet të ri Kombëtar për Mbrojtjen e Shëndetit Publik, i cili hartoi procedurat e parandalimit dhe mbrojtjes gjatë pandemisë. Qeveria greke zhvilloi raportime të përditshme televizive mbi situatën. Këto raportime bëheshin nga një zëdhënës/ekspert i Ministrisë së Shëndetësisë dhe një profesor i sëmundjeve infektive. Meqenëse qasja e qeverisë greke theksonte "marrjen në konsideratë të rekomandimeve të ekspertëve, centralizimin e vendimeve dhe depolitizimin e reagimit", publiku pranoi kufizime të tilla. Publiku grek ishte gjithashtu i vetëdijshëm për kufizimet e sistemit shëndetësor grek në krahasim me Italinë që u godit fuqishëm nga pandemia. Në këtë kontekst, njerëzit e kuptuan rrezikun, kështu që qëndruan në shtëpi (Petridou & Zahariadis, 2021, 4-5). Zyrtarët grekë flisnin gjithashtu njëzëri dhe ishin të koordinuar më së miri gjatë marrjes së veprimeve.⁵⁰ Për shembull, autoritetet greke standardizuan zbatimin e masave të izolimit, anuluan tubimet e mëdha dhe vendosën gjopa të larta prej 150 eurosh individëve që nuk zbatonin masat e izolimit të vendosura në periudhën 23 mars - 4 maj.⁵¹

Si përfundim, qeveritë me institucione të konsoliduara demokratike caktuan ekspertë për të komunikuar drejtpërdrejt me publikun. Këto qeveri kishin më pak gjasa që të vendosnin ndëshkime të rënda dhe të përpiqeshin të kontrollonin informacionin publik. Nga ana tjetër, demokracitë hibride – të karakterizuara nga kapacitete të dobëta të shëndetit publik dhe frika nga e panjohura – shfaqën tendencën të vendosnin dënime më të ashpra, të autorizonin zbatim më të militarizuar të kufizimeve dhe të kontrollonin e manipulonin informacionin publik.

⁵⁰<https://blogs.lse.ac.uk/greeceatlse/2020/04/13/regaining-trust-tackling-the-corona-virus-in-greece/>

⁵¹<https://euobserver.com/opinion/148397>

9. Konkluzionet

Pandemia COVID-19 rrezikoi të drejtën për të jetuar dhe sigurinë publike (kombëtare), dhe shumë qeveri morën masa të jashtëzakonshme për të kufizuar përhapjen e virusit. Pandemia demonstroi se fushat që përfshihen në kuadrin e sigurisë kombëtare, duhet të zgjerohen, me qëllim që të përfshijnë kërcënime më gjithëpërfshirëse të sigurisë siç janë krizat globale të mjedisit dhe shëndetit publik. Ndërsa fusha e shkencave politike i është referuar tradicionalisht sigurisë kombëtare si dimension për mbrojtjen e shtetit, territorit dhe popullsisë së tij nga kërcënime të jashtme ushtarake, ky studim ndërlidh sigurinë publike me sigurinë kombëtare në kontekstin shqiptar, me qëllim që trajtohet një koncept më i gjerë për sigurinë e shoqërisë dhe anëtarëve të saj gjatë një emergjence të tillë si një katastrofë natyrore ose një pandemi globale. Ky studim tregon se kur Shqipëria vendoset në kontekst rajonal dhe global, mund të vërehen disa modele. Së pari, vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor zbatuan masa të përkohshme të karantinës, të cilat kufizuan disa të drejta të njeriut. Përmes të dhënave, u konfirmua se masa të jashtëzakonshme të tilla si izolimet e realizuara në mënyrë efektive dhe të përkohshme kufizuan përhapjen e virusit COVID-19, gjë që reduktoi numrin e të sëmurëve dhe humbjen e jetëve. Shumica e qytetarëve i konsideruan masa të tilla të ashpra si të nevojshme në interes të mbrojtjes së sigurinë kombëtare dhe të së drejtës për të jetuar.

Për të shqyrtuar reagimin e Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19 nga një perspektivë rajonale dhe krahasuese, analiza jonë u mbështet në katër parime themelore të Këshillit të Evropës (2020a) - ligjshmëria, një kuadër i caktuar kohor për masat emergjente, domosdoshmëria dhe shpërndarja e pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimin ekzekutiv. Në përgjithësi, për sa kohë që përmbushen këto katër parime demokratike, qeveritë mund të shkelin përkohësisht të drejta të veçanta të njeriut, në mënyrë që të realizohen objektivat në situata emergjente. Gjatë reagimit ndaj pandemisë COVID-19, qeveria shqiptare plotësoi parimet e ligjshmërisë dhe kuadrin të caktuar kohor për masat emergjente, ndërsa plotësoi pjesërisht parimet e domosdoshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimin ekzekutiv.

Të drejtat kryesore që janë rrezikuar gjatë situatës emergjente të krijuar nga pandemia COVID-19 ishin të drejtat për lirinë e lëvizjes dhe organizmit të tubimeve. Demokracitë hibride me institucione të dobëta dhe besueshmëri të ulët të publikut ndaj qeverisë demonstrian kërcënime të caktuara për demokracinë dhe të drejtat e njeriut gjatë zbatimit të masave emergjente. Ndërsa ekzekutivi zgjeroi pushtetin e tij, kapacitetet e legjislativit dhe gjyqësorit për të mbikëqyruar hartimin dhe zbatimin e këtyre masave u tkurrën. Në këtë mënyrë, regjimet hibride në Shqipëri, Maqedoni të Veriut ose Serbi nuk i përmbushën plotësisht katër parimet e ligjshmërisë, kuadrin të caktuar kohor për masat emergjente, domosdoshmërisë dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimin ekzekutiv. Nga ana tjetër, Greqia, një demokraci e konsoliduar, plotësoi katër parimet, ndërsa Sllovenia, një

demokraci tjetër e konsoliduar, plotësoi parimet e ligjshmërisë, kuadrit të caktuar kohor për masat emergjente dhe shpërndarjes së pushtetit përmes kontrolleve mbi veprimin ekzekutiv, por vetëm pjesërisht parimin e domosdoshmërisë.

Disa masa tejkaloan fushëveprimin e tyre – atë spektër të nevojshëm për të kontrolluar përhapjen e virusit. Për shembull, kur qeveritë kërcënojnë mediat ose përdorin forcë të tepruar gjatë zbatimit të kufizimeve ndaj publikut, proceset demokratike afatgjata mund të dëmtohen. Për më tepër, kur masa të tilla kufizuese zbatohen dhe zgjaten në kohë në emër të një emergjence kombëtare, problematikat mbi institucionet e sundimit të ligjit, zgjedhjet e lira e të ndershme dhe liritë e medias mund të kërcënojnë seriozisht konsolidimin e institucioneve demokratike në një periudhë afatgjatë.

Deri në dhjetor të vitit 2020, masa të tilla emergjente kanë qenë të përkohshme, kështu që nuk po dëshmojmë përdorim të pacaktuar kohor të kompetencave të emergjencës nga qeveria e Shqipërisë ose shtetet e tjera të rajonit. Megjithatë, ekziston shqetësimi i ligjshëm se shpejtësia me të cilën qeveritë në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut zgjeruan pushtetin e tyre gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, mund të tregojëse legjislativi dhe gjyqësori mund të mos jenë në gjendje të garantojnë kontrolle dhe ekuilibra të mjaftueshëm për të frenuar tejkalimin e kompetencave të ekzekutivit. Këto vende, që të bëhen demokraci të qëndrueshme që mbrojnë të drejtat e njeriut, duhet të forcojnë institucionet e sundimit të ligjit dhe të zbatojnë me rigorozitet proceset demokratike.

10. Rekomandime për situatat emergjente

Siç u trajtua në këtë raport, në kohë krizash kombëtare, në mënyrë që të garantohet mbrojtja e shtetit të së drejtës, pushteti ekzekutiv duhet të ushtrojë kompetencat në bazës të procedurave dhe kushtetutëshmerisë. Ndërsa, disa kufizime të përkohshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mund të legjitimohen gjatë një situatë emergjence, në mënyrë që të mos kërcënohet siguria publike, përdorimi i tepruar i forcës, apo demonstrimi i formave militare nuk duhet të aplikohen gjatë zbatimit të këtyre rregullave. Në vijim jepen rekomandime specifike që burojnë nga ky studim mbi reagimin e Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19:

1. Gjatë periudhave të zgjatura të emergjencave publike (kombëtare), qeveria duhet të shmangë përdorimin e ushtrisë për të zbatuar masa kufizuese. Të drejtat e njeriut të tilla si liria e lëvizjes dhe e drejta për informim duhet të mbrohen në masën e mundshme brenda kuadrit të sigurisë publike. Një model alternativ ndaj përdorimit të ushtrisë dhe policisë për të zbatuar kufizimet gjatë emergjencave do të ishte përqendrimi tek ndërgjegjësimi dhe komunikimi me qytetarët. Në dy rastet e marra si referenca nga ana jonë – dy vende me demokraci të konsoliduar, Greqia dhe Sllovenia - qeveritë përkatëse u angazhuan drejtpërdrejt me qytetarët dhe u mbështetën në ekspertizën e profesionistëve të shëndetit publik për të miratuar masa të caktuara, zbatimi i të cilave ndryshonte në mënyrë të harmonizuar në varësi të rritjes së infektiveve me COVID-19.
2. Për të reduktuar kërcënimin e krijuar nga sfidat e jashtëzakonshme të shëndetit publik, siç është një pandemi, qeveria duhet të investojë në infrastrukturën e shëndetit publik, e cila ndihmon shoqërinë në kohë normale. Një infrastrukturë e konsoliduar në shërbim të shëndetit publik do të ndihmojë në ruajtjen e sigurisë publike përballë emergjencave të ardhshme shëndetësore.
3. Sulmet ndaj mediave nga zyrtarë të qeverisë rrezikojnë lirinë e shtypit, një përbërës thelbësor i një demokracie të konsoliduar. Media, duke përfshirë mediat sociale në internet, luan rol të rëndësishëm në informimin e publikut dhe shqyrtimin e masave të jashtëzakonshme të miratuara nga qeveria gjatë pandemisë. Në kohë emergjence, theksohet nevoja për mbrojtje më të madhe të integritetit të medias, në mënyrë që të rritet transparencja në vendimmarrjen e qeverisë dhe të kufizohet përhapja e dezinformimit të publikut.
4. Në një situatë emergjente për shëndetin publik siç është pandemia COVID-19, për të komunikuar me publikun dhe për të ruajtur shëndetin dhe sigurinë publike, qeveria duhet të mbështetet në informacione të besueshme nga ekspertë të shëndetit publik me njohuri të gjera mbi sëmundjen në fjalë. Në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, profesionistët e shëndetit publik dhe

Komitetet e Ekspertëve luajnë rol të rëndësishëm për informimin e publikut dhe rekomandimin e masave që qeveritë duhet të marrin për të mbrojtur shëndetin publik gjatë krizave të tilla si pandemia COVID-19.

5. Për të mbrojtur institucionet dhe proceset jetësore demokratike në kohë krizash, zgjedhjet duhet të mbahen me siguri, rregullsi dhe integritet. Nëse zgjedhjet duhet të shtyhen për shkak të një emergjence kombëtare, planifikimi i zgjedhjeve të reja duhet të miratohet përmes një konsensusi politik. Duhet të përcaktohet gjithashtu një afat i caktuar kohor për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Për të siguruar një proces të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, partitë e opozitës duhet të marrin garanci për zhvillimin e fushatës elektorale në një fushë me rregulla të barabarta loje me partitë në pushtet.

11. Referenca

Bianku, L. (2020). Albania: Some exceptional extraordinary measures. *Verfassungsblog: On Matters Constitutional*, 17 May.

<https://doi.org/10.17176/20200517-133231-0>.

Bieber, F., Prelec, T., Djolai, M., Emmini, D., Marović, J., Majstorović, S., Džihčić, V., Vračić, A., Balkans in Europe Policy Advisory Group (2020). *The Western Balkans in Times of Global Pandemic*.

<http://biepag.eu/wp-content/uploads/2020/04/BiEPAG-Policy-Brief-The-Western-Balkans-in-Times-of-the-Global-Pandemic.pdf>

Bonardi, J.-P., Gallea, Q., Kalanoski, D. and Lalive, R. (2020). "Fast and local: lockdown policies affect the spread and severity of covid-19". *Covid Economics*, 325–251.

Brändle, M., Brankovic, T., Dyrnishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Milacic, F., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M. (May 18, 2020a). *Democracy and the state of emergency: Political battles emerging out of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 2. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at:

<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16213.pdf>

Brändle, M., Brankovic, T., Dyrnishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M. (July 13, 2020b). *Democracy and the state of emergency: New upsurge of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 4. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at:

<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>

Cosse, E. (2020). Greece Again Extends COVID-19 Lockdown in Refugee Camps. HRW.

<https://www.hrw.org/news/2020/06/12/greece-again-extends-covid-19-lockdown-refugee-camps#>

Council of Europe (CoE). (2020a). *Respecting democracy, rule of law and human rights in the framework of COVID-19 sanitary crisis: A toolkit for member states*.

<https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1f40>

Council of Europe, (2020b). Coronavirus and prisons in the EU. Member state measures to reduce spread of the virus.

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/651976/EPRS_BRI\(2020\)651976_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/651976/EPRS_BRI(2020)651976_EN.pdf)

Cuckić, N., & Ivković, A. (2020). New low for parliamentary democracy in Serbia. *European Western Balkans*, 24 April.

<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>

Dragojlo, S., & Stojanovic, M. (2020). Serbian police 'allow pro-govt protesters to breach curfew'. *Balkan Insight*, 5 May.

<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>

Dyrmishi, A. (2020a). Albania. In Brändle, M., Brankovic, T., Dyrmishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Milacic, F., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M., *Democracy and the state of emergency: Political battles emerging out of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 2, pp. 4-7. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16213.pdf>

Dyrmishi, A. (2020b). Albania. In Brändle, M., Brankovic, T., Dyrmishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M., *Democracy and the state of emergency: New upsurge of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 4, pp. 4-7. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at:

<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>

Erebara, G. (2020). Rama takes his war on media to Albanians' phones. *Balkan Insight*, 13 March.

<https://balkaninsight.com/2020/03/13/albania-premier-urges-citizens-to-protect-themselves-from-the-media/>. Accessed 14 March 2020.

European Federation of Journalists. (2020). *COVID-19: Serbian government urged to guarantee free flow of information*. 3 April.

<https://europeanjournalists.org/blog/2020/04/03/covid19-serbian-government-urged-to-guarantee-free-flow-of-information/>. Accessed 4 April 2020.

European Parliament Briefing (2020). *States of emergency in response to Coronavirus crisis: Situation in certain member states*. Accessed at:

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/651914/EPRS_BRI\(2020\)651914_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/651914/EPRS_BRI(2020)651914_EN.pdf)

European Parliament (2020). COVID-19 Online Survey, Wave 1.

https://www.europarl.europa.eu/at-your-service/files/be-heard/eurobarometer/2020/public_opinion_in_the_eu_in_time_of_coronavirus_crisis/national-factsheets/covid-19-online-survey_ie_en.pdf

Exit News. (2020). *Albanian government proposes law granting police unchecked surveillance powers*. 28 May.

<https://exit.al/en/2020/05/28/albanian-government-proposes-law-granting-police-unchecked-surveillance-powers>.

Accessed 29 May 2020.

Freedom House. (2020). *Nations in transit 2020: Countries and territories*. <https://freedomhouse.org/countries/nations-transit/scores>
Accessed 15 July 2020.

International Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA). (December 2020). *Taking stock of global democratic trends before and during the COVID-19 pandemic. The global state of democracy in focus, Special Brief*. Accessed from: <https://www.idea.int/publications/catalogue/global-democratic-trends-before-and-during-covid19>

ISP (2020). Parlamenti në kohën e Pandemisë: Bilanci dhe problematika: raport monitories Janar – Korrik 2020. <https://isp.com.al/index.php/2020/09/05/parlamenti-ne-kohen-e-pandemise-bilanci-dhe-problematika/>

Luksic, I. (2020) Slovenia. In Brändle, M., Brankovic, T., Dyrmishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Milacic, F., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M., *Democracy and the state of emergency: Political battles emerging out of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 2, pp. 35-39. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16213.pdf>

Marinković, T. (2020). Fight against COVID-19 in Serbia: Saving the nation or securing the re-election? *Verfassungsblog: On Matters Constitutional*, 18 May. <https://doi.org/10.17176/20200518-133600-0>
Accessed 19 May 2020.

Markovikj, N. (2020). North Macedonia. In Brändle, M., Brankovic, T., Dyrmishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Milacic, F., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M., *Democracy and the state of emergency: Political battles emerging out of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 2, pp. 25-29. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16213.pdf>

OSCE 2020. *ODIHR Special election assessment mission. Republic of Serbia Parliamentary Elections*. Accessed at: <https://www.osce.org/files/f/documents/8/e/455155.pdf>

Petridou, E and Zahariadis, N. (2021) Staying at home or going out? Leadership response to the COVID-19 crisis in Greece and Sweden. *Journal of Contingencies and Crisis Management*.

Ruttershoff, T. (May 2020). *Albania: Autocratic measures in the shadows of corona*. Konrad Adenauer Stiftung, Albania Country Office.

Talevska, M. P. and Zoric, B. (2020). *Balkan barometer 2020: COVID-19 impact assessment*. Published by the Regional Cooperation Council (RCC). Accessed at: <https://www.rcc.int/pubs/97/balkan-barometer-2020-covid-19-impact-assessment>

Tepavac, T. and Branković, T. (2020a). Serbia. In Brändle, M., Brankovic, T., Dyrnishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Milacic, F., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M., *Democracy and the state of emergency: Political battles emerging out of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 2, pp. 30-34. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16213.pdf>

Tepavac, T. and Branković, T. (2020b). Serbia. In Brändle, M., Brankovic, T., Dyrnishi, A., Kabashi-Ramaj, B., Luksic, I., Markovikj, N., Tepavac, T., Zakosek, N., and Zivanovic, M., *Democracy and the state of emergency: New upsurge of the Corona crisis in the Western Balkans, Croatia and Slovenia*, Report 4, pp. 34-40. Published by Friedrich Ebert Stiftung. Accessed at: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16359.pdf>

Tzifakis, N. (April 2020). *The Western Balkans in times of the global pandemic*. BiEPAG Policy Brief. Accessed at: <http://biepag.eu/wp-content/uploads/2020/04/BiEPAG-Policy-Brief-The-Western-Balkans-in-Times-of-the-Global-Pandemic.pdf>

WFD and Krasniqi, A. (2020). *Impact on democracy of emergency measures against COVID-19: The case of Albania*. Institute for Political Studies (IPS).

WFD (2020a). Pandemic Democracy Tracker. <https://tracker.wfd.org/>

WFD (2020b). The role of civil society and media in crises management in Albania: The devastating earthquake of November 26, 2019 and COVID 19 Pandemic. Research team: Blerjana Bino, Orkidea Xhaferaj, Lutjona Lula.

12. Shtojca 1: Intervistat dhe Fokus-Grupet e realizuara në Shqipëri.

Lista e intervistave.

- Prof Dr. Arjan Starova, President, Këshilli Atlantik i Shqipërisë.
- Geron Kamberi, Drejtor Ekzekutiv, Center for School Leadership
- Ilir Kalemaj, Ph.D, Profesor dhe ekspert i shkencave politike, University of New York Tirana
- Prof Asoc Dr Perparim Kabo, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, ekspert i shkencave sociale
- Prof Dr Kristaq Xharo, Universiteti Evropian i Tiranës, Ekspert i sigurinë dhe studimet strategjike
- Arjan Dyrmishi, Drejtor, Qendra për Demokraci dhe Qeverisje
- Av. Prof. Asoc. Dr. Jordan DACI, Drejtor Ekzekutiv, Albanian Rule of Law Center, Ekspert i së Drejtës Kushtetuese.

Pjesëmarrësit të fokus-grupeve ishin përfaqësues të organizatave të mëposhtme:

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit – Tiranë
- Instituti i Studimeve Politike - Tiranë
- Iniciativa e Shqipërisë për Zhvillim – Tiranë
- Ekspert i shëndetit publik – Tiranë
- Universiteti “Luigj Gurakuqi” - Shkodër
- Me Komunitetin për ndryshim – Vlorë
- Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile – Durrës
- INFOCIP – Tiranë
- Durrësi Aktiv - Durrës
- Qendra për aktivitete rinore – Durrës
- Vizion i Gjelber – Vlorë
- Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm - Tirane
- Shoqata Joni – Sarandë
- Vizion Plus Media
- Top Channel Media
- Fax News
- Gazeta Liberal
- Euronews TV
- TVSH
- A2CNN
- TV Shijak

**Western Balkans
Democracy Initiative**



**Westminster Foundation for
Democracy (WFD)**

www.wfd.org/wbdi

